
Институт за комуникациски студии



Problemet Në Menaxhimin Me Resurset Ujore:
Si Ta Shfrytëzojmë Dhe Ta Mbrojmë Ujin

Dokument për politikë publike







Kthjellohu!

Dokumenti për politikë publike do të shërben si mjet në kampanjën për përfaqësim dhe lobim „Kthjellu“ të Institutit për studime komunikative, me të cilën do të bëhet ndikim në procesin e sjelljes së vendimeve dhe to të thiret audienca e synuar në veprim në sferën e menaxhimit me ujërat.
Në dokument përmbahen të dhëna dhe shqyrtim në problemet aktuale me menaxhimin e ujërave të cilat kërkojnë vëmendje të menjëhershme dhe ofrojnë zgjidhje të ndryshme dhe rekomandime konkrete për zgjidhjen e problemeve. Dokumenti bazohet në hulumtim dhe intervista me njohës të lëmisë.

Botues:
Instituti për studime komunikative
rr. „Jurij Gagarin“ 17-1-1, Shkup
www.iks.edu.mk

Për botuesin:
Profesor i Asociuar dr Zhaneta Trajkoska

Botim:
ResPublica

Autorë:
prof. d-r Biljana Pulevska
prof. d-r Nikola Popovski

Përktheu:
Hana Kasapi

Dizajn grafik:
Studio Igor Delov



British Embassy
Skopje



Ky proekt është përgatitur në kuadër të programit “Bashko pikat:politika të përmirsuara nëpërmjet pjesëmarrjes të qytetarëve” i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar me mbështetjen e Ambasadës Britanike Shkup. Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin ose mendimet e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Институт за комуникациски студии

respublica

Problemet Në Menaxhimin Me Resurset Ujore:
Si Ta Shfrytëzojmë Dhe Ta Mbrojmë Ujin

Dokument për politikë publike

Shkup,
shtator 2020

Përmbajtje

Rezyme **10**

1. Hyrje **14**

2. Probleme Me Menaxhimin E Ujërave Në Republikën E Maqedonisë Së Veriut **18**

Mungesë e dokumenteve planifikusese për menaxhim me ujërat 19

Mungesë e akteve nënligjore për implementimin e Ligjit për ujërat 22

Furnizimi me ujë dhe qasje deri në sistemin për furnizimin publik të ujit 22

Ndotja e ujërave nëpërmjet lëshimeve joligjore 23

Sisteme lokale, rurale për furnizim dhe siguria e ujit 25

Keqpërdorim i licencave për ujitje 27

3. Zgjidhje alternative e politikave publike-program për menaxhim të qëndrueshëm të ujërave në Republikën e Maqedonisë së Veriut **30**

4. Përfundim Dhe Referenca **48**

Shtojcë **52**

0

Zgjidhje alternative e politikave publike-program për menaxhim të qëndrueshëm të ujërave në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Masa 1:
Rishikim i strategjisë nacionale për ujërat 32

Masa 2:
Themelim i monitoringut operativ për regjione me rrjedha lumore 34

Masa 3:
Vendosje e qëllimeve për mjedis jetësor dhe miratim të programit të masave për arritjen e qëllimeve 35

Masa 4:
Krijim i planeve për menaxhim me rajonet me rrjedha lumore 37

Masa 5:
Sjellje e akteve nënligjore 39

Masa 6:
Sjellja e programit për furnizim me ujë të popullatës me sistem publik furnizimi 40

Masa 7:
Krijim i katastarit të shfrytëzuesve dhe ndotësve të ujit, evidentim i subjekteve që përdorin/lëshojnë në ujëra pa licencë dhe sanksionim 42

Masa 8:
Legalizim i furnizimit që bëhet nëpermjet sistemeve lokale,rurale të furnizimit me ujë 44

Masa 9:
Rishiqim i ligjit për ujëra dhe akteve nënligjore në aspekt të lëshimit të licencave/ vërtetimeve për nxjerjen e rërës, zhavorit dhe gurrit nga shtrati i lumit dhe nga brigjet e ujrave siperfaqësore 46

Rezyme

Dokumenti ka për qëllim të bën një analizë të thellë të të dhënave dhe rezultateve nga dokumentet strategjike, planifikuese dhe programore nga sfera e menaxhimit të ujërave, të legjislacionit nga sfera e menaxhimit me ujërat, si dhe të jep analiza dhe raport për statutin e menaxhimit me ujërat në nivel nacional dhe lokal. Dokumenti ka për qëllim të propozojë masa me qëllim të krijimit të kornizës konceptuale për zgjidhje të problemeve në sferën e menaxhimit të ujërave.

Sipas Ligjit për ujërat, menaxhimin me ujërat nënkupton marrjen a masave dhe aktiviteteve për shfrytëzim të qëndrueshëm, racional dhe efikas të resurseve të ujit, për mbrojtje të ujërave dhe mbrojtje nga veprimet të dëmshme të ujërave. Menaxhimi i ujërave përfshin masa dhe aktivitete për:

Menaxhimi i ujërave përfshin masa dhe aktivitete për:



Planifikim dhe marrje të masave dhe aktiviteteve për shfrytëzim racional dhe efikas të ujërave



Sigurim i qëndrueshëm i resurseve ujore



Mbrojtje e ujërave dhe



Mbrojtje nga ndikimet dhe veprimet e dëmshme të ujërave

Qëllimet e menaxhimit korespondojnë me qëllimet që duhet të përmbushen me përdorim të dospozitave të Ligjit për ujëra, përkatësisht, menaxhimi të krijon kushte për akses në ujë të mjaftueshëm, në radhë të parë të ujit cilësor për pije, dhe për tjera nevoja, mbrojtje, ruajtje dhe përmirësim të vazhdueshëm të resurseve ujore që janë në dizpozicion, truallit buzë bregut, ekosistemeve ujore dhe ekosistemeve të varura nga uji dhe llojllojshmërisë biologjike, dhe deri në ulje të plotë të lëshimeve të dëmshme dhe eliminimin gradual të emisioneve të materieve të dëmshme dhe substancave në ujë; zbutje të pasojave nga veprimi i dëmshëm i ujit dhe mungesa e ujit.

Masat e parapara do të duhet të t'i ballafaqohen sfidës për menaxhim të qëndrueshëm të resurseve ujore, ulje të rizikut për mjedisin jetësor, dhe në atë mënyrë, përmirësimit të statutit kualitativ dhe kuantitativ të resursit, perkatësisht përmirësimit të ndikimeve ekologjike, sociale dhe shëndetsore.

Dokumenti parasheh disa masa konkrete dhe intervenime konkrete për secilën nga dimenzionet relevante të menaxhimit dhe shfrytëzimit të ujërave si medium i mjedisit jetësor dhe ato, në kontekst të definimit të prioriteteve dhe masave, janë perpunuar më posht në tekst.

Lista e problemeve dhe masave të lidhura me menaxhimin e ujërave në dokument nuk është përfundimtare, por para se gjithash paraqet një listë prioritare. Definimi i prioriteteve dhe masave të qëndrueshme në dokument bazohet ne disa kritere:

- Vëllimi i ndikimit të problemit në politikën e përgjithshe të menaxhimit me resursin;
- Vëllimi i implikimeve finaciare dhe mundësia e zgjidhjes të problemit në nivel afatshkurtër/ mesëm;
- Ndikimi i zgjidhjes të problemit mbi mjedisin jetësor dhe
- Implikimet shoqërore nga zgjidhja e problemit.

Qëllimi kryesor i dokumentit është të kontribuojë në:

- Parandalimin e përkeqësimit të mëtutjeshëm dhe mbrojtje dhe avancim të ekosistemeve akuatike dhe mjediset jetësore ujore;

- Promovim i përdorimit të qëndrueshëm të ujërave të bazuar në mbrojtje afatgjatë të resurseve ujore;

- Ngritje e nivelit të mbrojtjes nga lëshimi dhe humbja e rastësishme e materieve ndotëse;

- Ulje e ndotjes e ujërave nëntokësore;

- Zbutje e pasojave nga vërshimet dhe tharjet;

- Arritje e qellimeve nga marëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare.

Gjatë analizës të të dhënave dhe rezultateve për qëllimet, masat dhe prioritetet, janë marrë parasysh dokumente dhe raporte relevante për gjendjen me menaxhimin e resurseve ujore, strategji dhe plane të veprimit për gjendjen e ujërave në nivel nacional dhe lokal, një numer i konsiderueshëm i dokumenteve sektoriale planifikuese dhe strategjike dhe legjislacioni i brendshëm në sferën e ujërave.

Të gjithë masat dhe qëllimet të përcaktuara në dokument nxjerren si detyrime ligjore dhe aktivitete per organet e pushtetit qendror dhe njësitë e qeverisjes lokale, në pajtim me dinamikën nacionale për zbatim.

Implikimet financiare që dalin nga masat dhe rekomandimet ne këtë dokument, në thuajse shumë të kompletuar do të jenë implikime fiskale që duhet të sigurohen nga shpenzimet publike të shtetit, më saktë nga buxheti i saj qendror. Ato janë të pregaditura në bazë te shfrytëzimit të të dhenave historike nga secili shpenzim i llogaritur adekuat, duke marrë parasysh çmimet mesatare të secilit lloj të shpenzimit potencial, dhe në bazë të praktikës të mbrendshme për llogaritje të implikimeve fiskale për shpenzime të ndara të buxhetit.

Implikimet totale financiare në 9 masat e propozuara llogaritet të jenë 1.086.017 euro, për të cilat pjesa me e madhe janë për punë ekspertësh– 512.700 euro dhe për angazhim të kompanisë ose kompanive për mbledhjen e të dhënave për ndotësit dhe përpunim dhe mirëmbajtje të zgjidhjes softuerike për katastar te ndotësve– 370.000 euro. 203.317 eurot e mbetura janë për: shpenzime në teren; përpunim të metodologjive dhe programeve; promovim të strategjive, debateve publike dhe ngritje e vetëdijes publike.


1.

Hyrje

Legjislacioni relevant maqedonas për menaxhimin me resurset ujore është sjellë në vitin 2008, paralel me proçesin e harmonizimit të legjislacionit tonë me aktet e Unionit Europjan. Përveç legjislacionit, që direkt regullon menaxhimin me ujërat, egzistojnë lidhje të rëndësishme me legjislacionin e mjedisit jetësor dhe me legjislacionin tjetër sektorial dhe horizontal, që ndikojnë në institucionet dhe veprimet në sferën e menaxhimit me ujërat. Kornizë koherente dhe normative e përgjithshme u caktua me ligjin për ujëra në vitin 2008. Me Ligj vendoset bazë ligjore për harmonizim të përgjithshëm me legjislacionin e UE dhe ai është i regulluar në bazë të direktivës Kornizë për ujëra dhe akteve tjera relevante të Unionit.

Menaxhimi me ujërat përbëhet nga masa dhe aktivitete për shrytëzim racional dhe efikas të ujërave, për zhvillim të qëndrueshëm të resurseve ujore, mbrojtje të ujërave dhe mbrojtje nga veprimet e dëmshme të ujërave, të cilat përfshijnë: krijim i politikave publike, ligjeve, dokumente planifikuese dhe strategjike; implementim të tyre nëpërmjet dhënies të licencave, monitorim, financim dhe kontrollë dhe mbikqyrje të inspekcionit. Menaxhimi i integruar me ujërat në Maqedoninë Veriore është regulluar me Ligjin e ujërave (87/2008, 6/2009, 161/2009, 83/2010, 51/2011, 44/2012, 23/2013, 163/2013, 180/2014, 124/2015, 146/2015, 52/2016), si ligj kornizë i cili vendos parimet, kompetencat, drejtat dhe detyrimet për menaxhim me ujërat. Struktura e Ligjit e reflekton menaxhimin e përgjithshëm të ujërave dhe atë **menaxhim me mbrojtje** të ujërave që i referohet mbrojtjes të mjedisit jetësor, që është qëllim primar i legjislacionit të ujërave të Bashkesisë Europjane dhe **menaxhimi me shfrytëzimin e resurseve ujore,** që i referohet shrytëzimit të ujit dhe mbrojtjes nga vërshimet, që nuk është çdoherë e lidhur me qëllimet ekologjike dhe me mbrojtjen e ujërave.

Në kontekst të harmonizimit të legjislacionit të mbrendshëm me përfitimet nga UE, për disa instrumente të Unionit (për cilësinë e ujit për pije, cilësinë e ujit për banjë, trajtimi me ujërat e zeza urbane) është evidente një shkallë e lartë ose e tërësishme e harmonizimit të legjislacionit.

Në raportin e Komisionit Europjan për Maqedoninë e Veriut nga viti 2019, për përparimin e shtetit në kreun 27[1], konstatohet përparim i caktuar në lidhje me cilësinë e ujit(janë zhvilluar plane për zbatim të Direktivave për ujë për pije, është sjellur program Nacional për investime në sektorin e

1.COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT North Macedonia 2019 Report Brussels, 29.5.2019 SWD(2019) 218 final në dispozicion https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-north-macedonia-report.pdf fq. 88

ujërave, zbatohet metodologjia e re e tarifave per shërbime ujore e bazuar në principin të kthimit të terë të shpenzimeve ; vijon debat publik për planet për menaxhim me rrjedhat lumore të lumejve Vardar, Strumicë dhe Drini i Zi; janë zhvilluar kartografi për vende me rrezik nga vërshimet për thuajse të gjitha rajonet e teritorit të RMV).

Si do qoftë, duhet të theksohet se harmonizimi i disa instrumenteve ende nuk ka filluar, dhe në përgjithësi, implementimi i legjislacionit është në nivel të ulët. Kjo, para se gjithash është për shkak të mungesës të akteve nënligjore, të cilat janë të rëndësishme për implementimin e ligjeve, me çka korniza ligjore nuk është e plotësuar, ligji është vetëm deklaracion për të drejta dhe detyrime pa implementim real faktik në shumë segmente të menaxhimit dhe në mënyrë konsekuente, resursi ujor nuk fiton mbrojtjen adekuate si medium i mjedisit jetësor, shfrytëzohet në mënyre iracionale, dhe e drejta e qytetarit për ujë të pijshëm i sigurt në aspektin shëndetësor dhe kushte sanitare është i vënë në pyetje dhe nuk realizohet plotësisht; nuk ka kapacitet institucional dhe pajisje për implementim dhe nuk ka mjete financiare të mjaftueshme nga buxheti shtetëror për implementimin e legjislacionit.

Përveç Ligjit për ujëra, zbatim subsidijar kanë edhe tjera lex specialis ligje, me të cilat regullohen aspekte të caktuara të menaxhimit, dhe aktet nënligjore të sjellura në bazë të atyre ligjeve[2] ose ligjet me të cilat regullohen tjera çështje horizontale ose lëmi, por tangojnë çështje të rëndësishme për menaxhimin me ujerat[3]. Me këtë, korniza ligjore nacionale karakterizohet si e vëllimshme, e komplikuar dhe multisektoriale. Përveç kësaj, në raportin e KE në mënyrë eksplicite thuhet se bashkëpunimi mes ministrive në sektorin, kërkon një permirësim të domosdoshëm[4]. Ky qëndrim rrjedh nga disa mangësi kyqe. Legjislacioni me të cilën regullohen aspektet e ndryshme të menaxhimit me ujërat nuk është plotësisht i konsoliduar, posaqërisht pas miratimit të Ligjit per ujëra, me të cilën harmonizohet legjislacioni I UE. Ligjet hynë në fuqi në periudha të ndryshme dhe shpesh pasojnë ndryshime, me çka vështirësohet implementimi i tyre i suksesshëm. Korniza aktuale nacionale implikon në menaxhim të përbashkët, e jo të integruar- jurisdikcionet janë të shpërndara në organe të ndryshme për menaxhimin me ujërat, çdokush në sferën e vet. Përgjegjësitë për aspekte të ndryshme të menaxhimit me ujërat janë ndarë mes organeve të ndryshme qendrore të administratës shtetërore. Më tej, kompetencat për menaxhimin me segmente të ndryshme të menaxhimit me ujërat jane ndarë mes organeve të ndryshme te administratës shtetërore. Menaxhimi aktual karakterizohet me mungesë të politikës koherente dhe të unifikuar nacionale për menaxhim

2. Ligj për regullimin e tarifave të shërbimeve ujore, Ligj për furnizim me ujë dhe përcjellje dhe trajtim me ujëra të zeza, Ligj për lundrim të mbrendshëm, Ligj për ujësjellje, Ligj për peshkim dhe akuakulturë, Ligj për përcaktimin të çmimeve të shërbimeve ujore, Ligj për liqenin e Ohrit, Prespës dhe Dojranit.

3. Ligji për mjedis jetësor, Ligj për menaxhi m me mbeturina, Ligj për ruajtjen e natyrës, Ligj për punë hidrometerologjike, Ligj për bashkësi bujqësore, Ligj për shpalljen e Liqenit e Dojranit për monument natyror.

4. Ibid. COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT North Macedonia 2019 Report Brussels, 29.5.2019 SWD(2019) fq. 88.

me ujëra, dhe organet që kanë kompetenca të ndërmarin aktivitete në sferë, nuk janë të koordinuar mes vete. Në legjislacion nuk është i paraparë mekanizëm për koordinim të politikave, strategjive dhe ligjeve. Pjesa më e madhe e përgjegjësisë dhe kompetencave për menaxhimin me Ligjin për ujëra është te Ministria për mjedis jetesor dhe planifikim hapësinor, por numër i madh i kompetencave janë paraparë dhe për tjera organe. Ligji e njeh nevojën për bashkëpunim, por nuk i mundëson instrumentet për implementim të tij. Kualifikacionet me të shumta janë: koordinimi, pajtimi, bashkëpunim i meparshëm, bashkëpunim, dhe këshillet e formuara për menaxhim me regjionet të rrjedhave lumore, të cilat duhet të jenë forume për të gjitha palët e interesuara, nuk janë në funkcion të paraparë me ligj. Më tej, detyrimet për shërbimet komunale dhe mbrojtja nga vërshimet janë në kompetencë të njësive të qeverisjes lokale në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale, por me Ligjin për ujërat janë transferuar edhe kompetenca tjera në nivel lokal (cilësia e ujërave për banjë). E gjitha kjo, në kontinuitet sjell deri te largimi i përgjegjësisë i të gjithë palëve të involvuara në lidhje me mosplotësimin ose plotësimin e pjesërishëm të detyrimeve në pajtim me ligjet; menaxhim i keq me resursin, si dhe pamjaftueshmëri dhe joefikasitet të shërbimeve ujësjellëse. Në kushte të varësisë prej ndihmave ndërkombëtare, krijohet një imazh i mosegzistimit i një partneri të vetëm i cili do të komunikojë me donatoret e huaj. Përputhshmeria në kompetenca shkakton dyfishim të administratorve të cilet kryejnë funkcione të ngjajshme ose të njejta, gjë që krijon implikime në nivel gjeneral.

Në drejtim të përmirësimit të politikës publike për ujerat, ekipi i Institutit për studime komunikative(ISK) bëri dhe një hulumtim më të thellë për aspektet e ndryshme të procesit të menaxhimit me ujërat. Metodologjikisht, janë konsultuar gjithë aktet ligjore dhe nënligjore relevante, raportet vendore për cilësinë e ujit, raportet statistikore për nivelin e furnizimit të ujit dhe për ujërat e zeza, plane akcionale lokale ekologjike të komunave, raporte të KE në lidhje me përparimin e shtetit, ku permenden dobësi dhe probleme në menaxhimin me ujërat. Më tej, qëllimi i këtij hulumtimi ishte të mblidhen dhe mendime të ndryshme dhe rekomandime nga ekspertë të sferës për menaxhim me ujëra. Me këtë metodologji janë identifikuar probleme të numërta të politikës publike aktuale për menaxhim me ujërat, të cilat krijohen në bazë të mungesës, regullimit joadekuat të aspekteve të caktuara të menaxhimit me ujërat në nivel nacional; probleme që lindin nga korniza institucionale dhe kapacitete të pamjaftueshme për zbatim të politikave-fuqi pune dhe buxhet, si dhe probleme që vijojnë si pasojë e mosrespektimit të regullativës.

Problemet e identifikuara, se bashku me ndikimet ligjore, sociale, ekonomike dhe politike që i shkaktojnë, jane të elaboruara në kreun e dytë.


2.

Probleme me menaxhimin e ujërave në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Mungesë e dokumenteve planifikuese për menaxhim me ujërat

Ligji per ujëra parasheh tre lloje te dokumenteve planifikuese te cilat duhet të miratohen me hyrjen në fuqi të Ligjit dhe atë:

- Strategji nacionale për ujërat, me të cilën percaktohet politika afatgjate për një periudhë prej 30 viteve;

- Baza e ekonomisë së ujit e Republikes së Maqedonisë së Veriut – gjendja aktuale e ujërave, zgjidhje teknike dhe ekonomike për shfrytëzim racional të ujërave dhe plan kohor për realizimin e tyre; dhe

- Plane për menaxhimin e rrjedhave lumore (për çdo rajon i rrjedhave të percaktuara me ligj) me periudhë planifikuese prej 6 viteve. Bëhet fjalë për mjete inovative për menaxhim të integruar të ujërave nëpermjet planifikimit.

Për dallim nga strategjia nacionale, që është sjellur në Kuvend në vitin 2010 dhe i takon periudhës prej 2011 deri në vitin 2014, baza e ekonomisë së ujit dhe Planet për menaxhim të rajoneve me rrjedhje lumore nuk janë miratuar. Strategjia për ujëra nuk përmban qëllime dhe prioritete konkrete strategjike për investim edhe as masa për zbatimin e tyre.

Baza e ekonomisë të ujit të Republikës së Maqedonisë është sjellur në vitin 1972. Problem është se baza e ekonomisë së ujit nuk ka rëndësi ligjore, por vazhdon të përdoret si dokument referent gjatë planifikimit të politikave në Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor. Plotësisht, baza e ekonomisë së ujit është marë parasysh në planin hapësinor të Republikës të Maqedonisë 2004-2020, dhe kështu zgjidhjet në planin hapësinor janë të parapara në pajtim me dokument të vjetër nga viti 1972. Kjo domethënë se

ska bazë të qartë për nevojat e ardhshme për ujë, për zgjidhjet teknike dhe ekonomike për shfrytëzim racional të ujërave, për mbrojtjen e ujërave nga ndotja dhe mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujit,në pajtim me parimet për zhvillim të qëndrueshëm, si dhe sipas qëllimeve afatgjata për mjedisin jetësor dhe programe për masa për realizimin e tyre.

Problemi bëhet edhe më i rëndë me joegzistimin e Planeve për menaxhim me rajonet më rrjedha lumore(PMRL) . Në teritorin e Maqedonisë, me ligj janë të përcaktuara 4 rajone te rrjedhave lumore, të cilat sipas njësisë të përgjithsme hidrografike, mund të kualifikohen si internacionale me karakter, sepse të gjitha rajonet e identifikuara, me pjesën e tyre më të vogël ose më të madhe shtrihen në teritorin e Maqedonisë dhe në teritorin e ndonjë shteti fqinj. Teritorin e shtetit e perbejnë: 1. Rrjedha e lumit Vardar; 2. Rrjedha e lumit Strumica; 3. Rrjedha e lumit Drini i Zi dhe 4. Rrjedha e lumit Morava Jugore[5]. Në pajtim me dispozitat të para dhe të fundit të Ligjit për ujërat, afati për sjelljen e PMRL është 6 vite nga hyrja në fuqi e Ligjit[6]. Përveç kësaj, në pajtim me Ligjin për ujëra, të drejtat ujore (licencat për shfrytëzim të ujërave, të drejtat për lëshim të ujërave) jepen në bazë të planit për rajon të caktuar dhe paraqesin një nga instrumenetet për implementimin e planit[7]. Nga kjo rjedh pyetja, nëse nuk egziston Plan, në çfarë bazë do të jepen licencat dhe si dhe në çfarë mënyre Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor nepërmjet këtyre licencave mban llogari për mirëmbajtjen dhe përmirsimin e regjimit të ujërave, përkatësisht të parametrave që e definojnë gjendjen kualitative dhe kuantitative të ujërave në vend të caktuar dhe ne kohë të caktuar (rrjedhja e ujit, kahja e rrjedhjes, shpejtësia e ujit, karakteristikat fizike, kimike dhe radioaktive, përmbajtja hidrobiologjike e ujit dhe parametra tjerë)[8]. Kjo gjendje, përveç që paraqet bazë për arbitrazh gjatë dhënies të licencave, nuk jep garancion se qëllimet e Ligjit për mbrojtje, rrujtje dhe përmirsim të resurseve ujore nëpërmjet shfrytëzimit racional të qëndrueshëm, do të arrihen. Kjo do të thotë se vihet në pyetje qasja në ujë të mjaftueshëm cilësor para se gjithash të pijshëm, dhe më tej dhe për nevoja tjera (në bujqësi, industri, nevoja hidroenergjetike, turizëm, lundrim, rekreacion dhe për nevoja tjera), mbrojtje dhe përparim të mjedisit jetësor dhe natyrës, i ekosistemeve ujore dhe i llojllojshmërisë biologjike dhe mbrojtje e shëndetit te qytetarëve, si dhe ulja e lëshimeve të dëmshme dhe eliminim gradual i lëshimeve të materieve dhe substancave të dëmshme në ujëra.

Mungesa e dokumentacionit planifikues dhe strategjik, përveç asaj që e cekëm më lart, sjell edhe deri te **nënprobleme** tjera në zbatimin e legjislacionit.

5. Shiko nenin 7 paragrafi 2 nga Ligji për Ujëra; Vendim për caktimin e kufijve të regjioneve të rrjedhave lumore (G.zyrtare e RM nr. 107/2012 од 27.08.2012).

6. Në pajtim me raportin Commission Staff Working Document North Macedonia 2019 Report Brussels, 29.5.2019 SWD(2019) fq. 88.

7. Neni 66 nga Ligji për ujëra : „(7) Planet e menaxhimit me rrjedhën lumore bëhen nëpërmjet dhënies të licencave dhe me tjera instrumente te caktuara me këtë ligj". .

8. Ibid. Neni 12

Evidente është nga të dhënat statistikore, ndërmarjet komunale lëshojnë ujë të papastruar me shkallë të lartë të materieve ndotëse. Kjo do të thotë se, ose licenca në bazë të cilës bëhen lëshime nuk ka vlera të kufizuara të lëshimeve për shkak të mosegzistimit të dokumenteve planifikuese, ose ndërmarjet nuk janë bartës të licencës për lëshim. Në të dyja rastet, ky veprim është praktike joligjore që është në kundërshtim me Ligjin për ujërat.

Në shtetin tonë, me strategjitë per zhvillim të energjetikës dhe burimeve ripërtrirëse të energjisë dhe me hulumtimet për centrale të vogla hidroelektrike, nxitet ndërtimi i centraleve të vogla hidroelektrike dhe kapacitete për prodhim të energjisë elektrike të pastërt ekologjike. Por, ndërtimi i tyre sjell pasoja të papara në biodiversitetin dhe sjell deri te zhdukja e disa llojeve endemike të kafshëve dhe bimëve, posaqërisht nëse ato ndërtohen në rajone të mbrojtura. Në pajtim me legjislacionin për mjedis jetësor, strategjitë për zhvillim të energjetikës dhe burimeve ripërtrirese të energjisë janë subjekt i veprimit për vlerësim strategjik të ndikimit të tyre mbi mjedisin jetësor dhe mbi shëndetin e njerëzve. Si do qoftë, gjatë implementimit të bazës strategjike, për shkak të mungesës të dokumentit strategjik planifikues referues nga sfera e ujërave, nuk është e qartë si vlerësohen ndikimet në mjedisin jetësor çka i shkaktojnë strategjitë për zhvillim të energjetikes dhe burimeve ripërtsirese të energjisë. Përveç kësaj, sistemi për përcjelljen e efekteve mbi mjedisin jetësor dhe mbi shëndetin e njerezve nga zbatimi i dokumentit planifikues nuk është funkcional, si dhe efektet e paparashikuara negative dhe marrja e masave adekuate për regullim të situatës janë vetëm detyrime formale në letër.

Në këtë kontekst, është relevant dhe veprimi për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor nga proekte të caktuara, në rastin konkret-proektet për hidrocentrale të vogla. Implementimi i këtij detyrimi ligjor, edhe pse mundëson vlerësim të ndikimit të një proekti konkret veçanërisht, nuk e vlerëson ndikimin kumulativ nga disa proekte në një rrjedhë ujore të njejtë. Në këtë mënyrë, proektet për hidrocentrale të vogla seriozisht ndryshojnë ekosistemet në lumenj, shumë shpesh duke e fragmentuar shtratin dhe shkaktojnë ndryshim në kahjen e lumejve, e problematizojnë rrjedhjen të lejuar minimale ekologjike, përkatësisht nivelin që e rrezikon biodiversitetin dhe llojet endemike, paraqitet shkallë e lartë e nutrienteve, degradohet cilesia e ujit, ndryshon peisazhi dhe zvogëlohet sasia e ujit që në menyrë prioritare duhet të shfrytëzohet për qëllime tjera, me çka shkaktohen probleme të shumta socioekonomike.

Mungesa e akteve nënligjore për implementim të ligjit për ujërat

Nga gjithsej 106 baza ligjore në Ligjin për ujëra për sjelljen e akteve nënligjore me të cilat duhet të sigurohet implementim i Ligjit dhe arritje të qëllimeve të tij, për 52 nuk janë sjellur akte nënligjore. Shumica e tyre janë në lidhje me qëllimet për mjedisin jetësor dhe vlerat të kufizuara të lëshimeve për ujëra sipërfaqësore dhe ujëra nëntokësore, për zonat e mbrojtura, lëshimet e lejuara, mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave, monitoring i ujërave dhe sisteme informative, si dhe në menyrën e mbajtjes të evidencës dhe mënyrës së llogaritjes të njësisë së dëmit dhe pagesave. Me atë, të drejtat dhe detyrimet të parapara me Ligjin për ujëra nuk mund të implementohen në mënyrë adekuate.

Furnizimi me ujë dhe qasje në sistem publik për furnizim

Furnizimi i popullatës me ujë cilësor për pije eshtë prioritet i rëndësishëm i çdo shteti. Me regjistrimin e popullatës, amvisërive dhe banesave, si hulumtim statistikor që e përfshin e gjithë popullatën, regullisht mblidhen edhe të dhëna për mënyrën në të cilën amvisëritë furnizohen me ujë të pijshëm, si dhe për pajisjen e njësive strehuese me instalime për furnizim me ujë të pijshëm. Edhe pse 88,9% nga numri i përgjithsëm i amvisërive individuale furnizohen me ujë të pijshëm nga ujësjellësi publik, që paraqet tregues të lartë statistikor, vetë fakti që në fillim të shekullit 21, në zemrën e Europës, ende një pjesë e amvisërive pijnë ujë e cila, as në karakter biologjik, e as në atë kimik, nuk është e kontrolluar, paraqet tregues i cili duhet të na brengos. As fakti që numri më i madh i amvisërive që nuk furnizohen me ujë të pijshëm nga ujësjellsi publik janë të koncentruar më së shumti në lagje rurale, rallë të banuara-nuk mund të jetë arsyetim për kujdesin e pamjaftueshëm të shtetit, në çdo banesë të sjellet ujë cilësor për konsum nga ana e njeriut[9]. Në disa komuna, për shkak të mungesës të ujit të pijshëm, ka bunarë të rinj ose të vjetër që shfrytëzohen, posaqërisht në zonat në lagje të vjetra dhe të jourbanizuara. Këto ujëra nuk janë të kontrolluara dhe nuk ka të dhëna për sigurinë dhe kriteret për cilësi, posaqërisht në aspekt mikrobiologjik dhe kimik. Kjo tregon se 11,1 % nga numri i përgjithshëm i amvisërive individuale nuk kanë qasje deri në ujë të pijshëm. Në nivel Republikan, egzistojnë dallime domethënese në mbulimin e vazhdueshëm të shërbimeve për furnizim me ujë në rajone. Mbulimi më i lartë me menaxhim të regullt dhe përcjellje- furnizim qendror është parë në Rajonin e Shkupit(rreth 91%), ndërsa mbulim më i ulët është regjistruar në rajonin e Pologut, rajonin verilindor dhe jugoverior(66 deri 75%). E drejta e njeriut për ujë është e domosdoshme për të jetuar një jetë

9. Statisitika për mjedisin jetësor2019,Enti shtetëror për statistikë, f. 66, publikimi është në dispozicion në http://www.stat.gov.mk/Publikacii/ZivotnaSredina2019.pdf

dinjitoze dhe njerëzore. Qasja në ujë është conditio sine qua non për të drejtën e jetës, për të drejtën e standardit adekuat jetësor dhe të drejtën për shëndet. Sigurimi i qasjes në ujë për të gjithë njerëzit nuk është vetëm çështje e aksesit në resurset ujore[10], teknologjisë dhe infrastrukturës, por është çështje e prioriteteve, zgjidhje e varfërisë dhe jobarazisë dhe zgjidhje e disbalancit social[11]. Në pajtim me Ligjin për ujëra, furnizimi publik i popullatës është furnizimi me ujë për pije për më shumë se pesë amvisëri, përkatësisht për më shumë se 20 qytetarë, furnizimi nga objektet personale dhe ndërmarjeve dhe personave tjerë juridike që prodhojnë dhe/ose kryejnë qarkullim me ushqim dhe pije dhe furnizime të objekteve publike. Detyrimin për marrjen e masave të duhura për zhvillim dhe mirëmbajtje të sistemit efikas dhe ekonomik për furnizim me ujë për pije në sasi të mjaftueshme dhe sipas kërkesave, deri te gjithë shfytëzuesit ligjor është detyrim i vetëqeverisjes lokale sipas nenit 185 të Ligjit për ujëra.

10. Në pajtim me Regulloren për sigurim të ujit të pijshëm(„G. Zyrtae e RM " nr.57/04), si dhe direktivat europjane në këtë sferë, definohet nevoja për uj në 150l në njeri

11. Pakti ndërkombëtar për të drejta politike dhe qytetare dhe Pakti ndërkombëtar për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore në mënyrë implicite njohin të drejtën për ujë. Pakti ndërkombëtar për të drejta qytetare dhe politike është miratuar ne 16 dhjetor në vitin 1966,hyn në fuqi në 23 mars 1976, G.A Res. 2200A (XXI), document I OKBA / 6316 (1966), 993 UNTS; pakti ndërkombëtar per të drejta ekonomike,socijale dhe kulturore, të sjellur në 16 dhjetor 1966, hyn në fuqi në 3janar të vitit1976, G.A. Res. 2200A (XXI), document I OKB. A / 6316 (1966), 993 UNTS;

Ndotja e ujërave nëpërmjet lëshimeve joligjore në ujëra

Ndotja e ujërave është rezultat i hyrjes të materieve të dëmshme, substancave, ose materieve toksike ose ndotëse dhe mbeturinave në trupat ujore. lëshimi i mbeturinave industriale dhe bujqësore, ujërave të zeza urbane, si dhe vajërave në kanalizim, në ujërat siperfaqësore ose nëntokësore, ose në sistemet për ujitje sjell deri te ndotja e ujit.

Sipas Ligjit për ujëra, ujërat urbane të zeza dhe ujërat industriale të zeza duhet të trajtohen në mënyrë adekuate para se të lëshohen në marrësin(lum ose kanal i hapur). Nëse lëshimi bëhet në lum ose kanal të hapur si marrës, ai duhet ti plotëson kriteret për lëshim në pajtim me kategorizimin të kahjes të ujit të caktuara me Direktivën për klasifikim të ujërave, përkatësht me Direktivën për kategorizim të kahjeve lumore(G. zyrtare e RM PM nr. 18/99), përkatësisht me Direktivën për klasifikim të ujërave sipërfaqësore (G. zyrtare e RM nr. 99/16). Çdo lëshim i ujërave industriale të zeza duhet të bëhet nën kushte dhe në mënyrë të caktuar me licencë për lëshim, përkatësisht me licencë të integruar ekologjike në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor(G. zyrtare e RM nr. 50/05).

Sipas të dhënave statistikore[12], në Maqedoni, lëshimi i ujërave të zeza nga industria dhe xehtaria, bëhet në marrës, pa berë asnjë trajtim mbi të. Si marrës të ujërave të zeza janë: trualli, kanalizimi, rrjedha lumore, akumulimet dhe liqenet. Në vitin 2017, nga të gjithë ujërat e zeza të papastruara të lëshuara nga industria dhe xehtaria, 0.3% janë

12. Statisitka per mjedisin jetësor2019, fq 77

lëshuar në kanalizim, dhe 99.7% në rrjedha lumore. Në vitin 2017, në liqene nuk janë evidentuar lëshime të ujërave të zeza të papastruara nga industria dhe xehtaria. Nga të dhënat nga Enti statistikor të mjedisit jetësor, regjistrohen koncentrime të larta të materieve ndotëse[13].

Në Maqedoni pastrohen vetëm rreth 3-4% nga sasia e përgjithshme e ujërave të zeza nga xehtaria dhe industria. Ky indikator e tregon gjendjen për lëshimin e ujërave të zeza, mbi të cilat, pas përdorimit është kryer pastrimi. Ato janë pastruar në mënyrë të caktuar (mekanike, kimike, biologjike ose të kombinuar) dhe si ashtu, lëshohen në ndonjë marrës, më shpesh në kanalizimin publik. Sasia e përgjithshme e ujërave të zeza të papastruara në vitin 2018 është zvogëluar për 10.6% në krahasim me një vit para. Më teper ujëra të zeza janë lëshuar në rrjedha lumore, nga ato 41,7% janë të papastruara dhe 20,8% jane ujëra të zeza të pastruara.

Duhet të përmendet se pastrimi i ujërave të zeza varet shumë nga korrektësia teknike e mjeteve për atë qëllim, dhe ndërtimi i pajisjeve të reja nuk tregon tendencë të rritjes të konsiderueshme. Pjesa më e madhe e sistemeve kanalizuese është në gjendje të keqe. Kolektori i ndërtuar dhe stacioni i pastrimit në dy qytete janë në gjendje të keqe dhe për shkak të mirëmbajtes të paregullt dhe defekteve, shumë shpesh nuk funksionojnë[14]. Gjashtë komuna tjera më të vogla kanë stacione më të vjetra për pastrim që funkcionojnë me veshtirësi për shkak se janë të vjetëruara dhe ka mungesë të mjeteve për mirëmbajtje[15]. Stacione funksionale për pastrim të ujërave të zeza, deri në vitin 2017, ka në dy qytete[16], të reja janë ndërtuar në pesë[17] dhe të lëshuara në përdorim ne vitin 2018[18]. Ministria e mjedisit jetësor[19], Ministria për Transport dhe Lidhje dhe Qyteti i Shkupit dhe komunat[20] janë të detyruara të bëjnë mbikqyrje dhe të mundësojnë që efluentët(lëshimet) nga ujërat e zeza industriale dhe ujërat e zeza urbane në rajonin e tyre që hyjnë në sistemet e mbledhjes dhe pastrimit të ujërave të zeza urbane t'ju nënshtrohen një paratrajtimi[21]. Ç'do lëshim duhet ti plotëson kriteret (vlerat të kufizuara për emision për parametrat, si dhe qëllimet për çdo trup ujor). Bartësit e licencës për lëshim në pajtim me ligjin duhet ta paguajnë tarifën për lëshim, në llogari të veçantë brenda llogarisë arkare, dhe mjetet e mbledhura duhet të përdoren për 1) pregaditje dhe organizim të zbatimit të masave për mbojtje të ujërave nga ndotja; 2) monitorim dhe përcaktim të gjendjes së cilësisë

13. Statistika për mjedisin jetërsor 2019, fq. 69-74

14. Ohri dhe Struga.

15. Kratovë, Llozovë, Resnja, Gradsko, Makedonski Brod, Dojran.

16. Kumanovë dhe Berovë.

17. Strumicë, Kërçovë, Prilep, Gjevgjeli, dhe Radovish Ibid. fq53. Në Gostivar, Vinicë, Krushevë, dhe Debrca nuk ka pastrim. Raport përfundimtar për revision të kryer të suksesit „Efektivitet nga politikat,masat dhe aktivitetet gjatë dhënies të drejtës ujore, 02 218 03 65Enti shtetëror për revizion, Shkup,shkurt 2019, fq. 53

18. Raporti përfundimtaar për revizon të kryer të suksesit „Efektivitet te politikave,masave dhe aktiviteteve gjatë dhënies të drejtës ujore, 02 218 03 65 Enti shtetëror për revizion, Shkup, shkurt2019, fq. 7, në dispozicion ne faqen. https://dzr.mk/Uploads/65_RU_Dodeluvanje_vodno_pravo_2019_KOMPLET_REDUCE.pdf

19. Ligji për ujëra (2008) Neni 78 (2) Organi i aparatit shteëror kompetent për kryerje të punëve nga sfera e mjedisit jetësor është i obliguar të siguron se licenca e dhënë është në pajtim me kriteret aktuale për siguri të ujit dhe qëllimeve të mjedisit jetësor, të përcaktuara me këtë ligj.

20. Ibid. Neni 113 dhe neni 114

21. Ibid. Neni 115, 116 dhe117

22. Raporti përfundimtar për revision të kryer të suksesit "Efektivitet nga politikat masat dhe aktivitetet gjatë dhënies te drejtës ujore(2019), fq. 7

23. Ibid. Neeni 254

24. Raporti përfundimtar për revision të kryer të suksesit "Efektivitet nga politikat masat dhe aktivitetet gjatë dhënies të drejtës ujore(2019), fq 7

dhe sasisë të ujërave për konsumim nga ana e njeriut dhe 3) përcaktim dhe mbajtje të zonave të mbrojtura nga ky ligj dhe ndërtim dhe mirëmbajtje të objekteve për mbrojtje të ujerave nga ndotja. Me shumë se gjysma nuk bëjnë ose pjesërisht bëjnë pagesë për shumën e llogaritur për shfytëzimin e ujit[22].

Nga dispozitat të para dhe të fundi të Ligjit[23], është i paraparë afat prej një viti për sigurimin e licencës për lëshim. MMJDPH nuk ka evidencë dhe të dhëna precize për numrin e kërkesave për lëshim në ujë dhe licenca të dhëna. Nga 138 kërkesa të pranuara për të drejta ujore, pozitive janë 46%, janë refuzuar 17%, dhe të pazgjidhura janë 36%. Nga gjithsejt 36 ndërmarje publike të cilat bëjnë mbledhjen, heqjen dhe/ose pastrimin e ujërave të zeza, vetëm katër kanë leje, por të dhënat për licencat/vërtetimet nuk janë të shpallura publikisht në web faqen e Minsitrisë të mjedisit. Komunat që kanë stacione të reja të pastrimit të hapura për punë deri ne vitin 2018 nuk kanë licencë[24].

Siç është evidente, këto lëshime joligjore pa licencë janë në kundërshtim me Ligjin për ujëra dhe me Ligjin e mjedisit jetësor. Në Ligjin për ujëra, në disa dispozita në mënyrë eksplicite thuhet se ka ndalesë për lëshime direkte në ujërat nëntokesore, si dhe lëshime në ujërat sipërfaqësore.. Në rastin e dytë ,lëshimi është i mundur me përjashtime, vetëm në bazë të licencës dhe plotësimit të kritereve.[25]

Sisteme për furnizime lokale, rurale dhe siguria e ujit

Në teritorin e vendit, 10% e popullatës furnizohet me ujë për konsum nga ana e njeriut dhe për tjera nevoja të amvisërisë nëpërmjet sistemeve lokale, rurale për furnizim me ujë, me të cilat menaxhojnë bashkësitë lokale, dhe 11% tjera kanë furnizim personal individual. Sistemet më të vogla furnizuese që janë ndërtuar në komunat afër qyteteve janë kryesisht të ndërtuara nga vetë qytetarët me anë të vetëfinancimit, ose me kombinim me donacione dhe ato janë ende në funkcion të furnizmit të popullatës vendase. Furnizimi me ujë nepërmjet këto sisteme ndryshon edhe në lidhje me cilësinë edhe me sasinë e ujit. Bashkësitë lokale, përkatësisht bashkesitë urbane në shtet, nuk kanë statut të personave ligjore, dhe menaxhimin e sistemit të furnizimit e bëjnë në mënyrë joformale. Nga kontrollet e bëra sanitaro-higjienike të sigurisë

25. Ibid. Neni 6 „ndalohet çdo leshim të ujerave të zeza, materie dhe substance ne ujë përveç në kushte mënyrë dhe veprim te përcaktuara me ligj; ιлен 14 (3) „çdo shfrytëzuesi ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore , realizim të drejtave dhe dertyrimeve te subjekteve fizike dhe ligjor të shfrytëzojnë ose të derdhin ujëra, e drejta për shfrytëzim të ujerërave nga trupat ujor dhe e drejta për derdhjenë trupat ujore, jepet e drejtë ujore për subjektet fizike dhe juridike në tekstin më poshtë:e drejta ujore) në kushte dhe mënyrë të vërtetuara me këtë ligj; Neni77 (1) Çdo veprim ose aktivitet me të cilën ndoten ujërat ose derdhen ujëra të zeza ose mosveprim me të cilën do të ishte mundësuar ndotje e ujërave ose derdhje e ujërave të zeza është e ndaluar;neni 78 (1) Çdo derdhje në ujëra, truallin buzë bregut dhe mjediset ujore bëhet në bazë të licencës ne pajtim me kriteret per cilësi të ujit dhe qëllimettë mjedisit jetësor të përcaktuara me këtë ligj dhe shkrim tjetër, neni 79 (1) Subjektet fizike dhe juridike, duke I përfshirë dhe organet të aparatit shtetëror, komunat, komunat në qytetin e Shkupit mund të derdhin ujëra të zeza ose të derdhin dhe të hedhin materie dhe substance në marësin vetëm me licencë të siguruar paraprakisht per derdhje në ujëra (në tekstin më poshtë:leje për derdhje), në kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj; neni 110 (1) derdhje të efluentit nga mbeturin të lëngshme industrial dhe bujqësore dhe ujëra të zeza urbane, si dhe vajëra (më poshtë në tekst:ujëra të zeza) në kanalizim ose në system për ujitje, në trupa ujorë sipërfaqësor dhe nëntokësor, si dhe në trualle buzë bregut dhe mjedise ujore, ndalohet, lejohet vetëm në bazë të licencës nga neni 79 të këtij ligji в; neni 111 (1) Me qëllim të mbrojtjes të ujerave nëntokësore ndalohet çdo derdhje direkte të materieve prioritare dhe substancave dhe materieve ndotëse në ujerat nëntokësore etj.

shëndetsore të ujit për konsum nga ana e njeriut nga këto sisteme për furnizim me ujë, 27% nga mostrat a marra kanë qenë të pasigurta në aspekt të parametrave mikrobiologjike[26]. Në Ligjin për furnizim me ujë për konsum dhe heqje të ujerave të zeza urbane[27] është paraparë afrim i këtyre sistemeve kah ndërmarjet publike, që bëhet me marëveshje[28]. Këto sisteme të furnizimit me ujë janë ndërtuar me mjete te qytetarëve, me donator vendas dhe të huaj ose tjerë, dhe për atë arsye egziston rezistencë te qytetarët. Njëkohësisht, nuk ka interes për marrje të sistemeve nga ana e ndërmarjeve publike për shkak të asaj se janë më të vjetëruara dhe për shkak të shpenzimeve të larta per mirëmbajtje, rekonstruim dhe furnizim.

Sipas Ligjit per ujëra, çdo furnizim me ujë për konsum nga ana e njeriut për më teper se pesë amvisëri, përkatësisht për më tepër se 20 qytetarë, furnizim në objektet private, të ndërmarjeve dhe subjekteve tjera ligjore të cilat prodhojnë ose/dhe bëjnë qarkullim të ushqimit dhe pijeve dhe furnizim të objekteve publike(institucioneve edukativo-arsimore, institucioneve shëndetsore, subjekteve ligjore nga lëmia e turizmit dhe hotelierisë, komunikacionit etj,), njihet si furnizim publik. Ligji parasheh që personat ligjor dhe fizik që shterin, marrin ujë për furnizim publik duhet të sigurojnë licencë për shfrytëzim të ujit. Përveç kësaj, egziston detyrim për siguri në aspekt shëndetësor dhe plotësim të vlerave minimale dhe standardeve dhe parametrave për siguri të ujit në lidhje me parametrat mikrobologjike, parametrat fizike dhe kimike, parametrat radiologjike dhe indikatorët biologjik(fito dhe zooplankton) për furnizim me ujë nga ujëra siperfaqësore dhe nëntokësore dhe bunarë të caktuar. Ligji është decid se këto veprime dhe shërbime me interes publik do të kryhen nga subjekte ligjore të themeluara në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë ose me vendim të këshillit të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit, Këshillit të Qytetit të Shkupit, në pajtim me kompetencat e tyre të përcaktuara me ketë ose ligj tjetër, në mënyrë dhe në procedurë të caktuar me ligj. Pastaj aktivitetet dhe shërbimet mund ti kryejnë dhe subjekte tjera ligjore, në mënyrë dhe procedurë te caktuar me ligj , duke u bazuar në ligj për koncesione dhe partneritet publik-privat, ku është regulluar mënyra se si subjektet private e ndërmarin detyrimin të sigurojnë shërbim publik për shfrytëzuesit në rajone në kompetencë të shtetit/njësive për vetëqeversije lokale NJVL. Dispozita të ngjashme përmban dhe ligji për veprim komunal (ndërtim i sistemit për furnizim me ujë, përpunim dhe furnizim me ujë për konsum nga ana e njeriut, me çka nënkuptohen përpunim dhe distribuim të ujit nëpërmjet sistemit furnizues, quhet si veprim komunal[29]) Verpimtaria komunale, si veprimtari në interes publik, është në kompetencë të shtetit dhe NJVL dhe subjektve ligjore të cilat i themelojnë . subjekte tjera ligjore mund të bëjne veprimtari vetëm

26. Raport përfundimtar për revizion të kryer të suksesit „Efektivitet të politikave,masave dhe aktiviteteve gjatë dhënies të drejtës ujore (2019), fq. 9

27. Ligji për furnizim me ujë të pijshëm dhe mbledhje të ujerave të zeza (Gazeta zyrtare e RM nr. 68 / 04, 28/06, 103/08, 17/11, 54/11, 163/13, 10/15, 147 / 15, 31/16)

28. Neni 32 I Ligjit për furnizim dhe trajtim të ujërave të zeza

29. Ligji për veprimtari komunale (Gazeta zyrtare e RM nr.95/12, 16/13, 42/14, 44/15 и 147/15)

nëse janë të regjistruar për kryerje të veprimtarive të caktuara komunale dhe kanë licencë për kryerje të veprimtarisë komunale në pajtim me ligjin. Veprimtaria komunale kryhet në pajtim me ligj të posaçëm dhe rendit komunal, dhe objektet për strukturë komunale, në pajtim me ligjin, percaktohen si të mira në interes publik. Gjithashtu, në Ligjin për furnizim me ujë, lëshim dhe trajtim të ujërave të zeza janë veprimtari me interes publik, dhe veprimtaritë kryhen nëpërmjet sistemit për furnizim, edhe atë, sistem kanalizimi me të cilën detyrimisht menaxhon dhenësi i shërbimeve. Dhënës i shërbimeve mund të jetë vetëm ndërmarje publike e themeluar nga komuna, nga Komuna e Shkupit, nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ose subjekt juridik që plotëson kushtet për veprimtari të parashikuara me ligj dhe në të cilin subjekt, pjesëmarrje dominante me kapital ka komuna, Qyteti i Shkupit ose shteti.

Keqpërdorim i licencave për nxjerrje të rërës,zhavorit dhe gurit dhe mungesa e masave për mbrojtje nga punimit joligjor

Nxjerja e rerës, zhavorit dhe gurit nga shtrati dhe bregu i lumejve është masë për regullim dhe mirëmbajtje të ujërave siperfaqësore[30]. Për nxjerrjen e rërës, zhavorit dhe gurit nga shtretërit dhe brigjet e lumejve, liqeneve dhe akumulimeve, për shkak të përmirësimit të regjimit të ujërave, janë kompetent ekonomitë të ujit të reonit të veprimit, dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale janë kompetente në rajonet ku nuk janë themeluar. Në Ligjin për ujëra egziston ndalesë të nxjerret zhavor, rerë dhe gurë nga shtretërit dhe brigjet e trupave ujorë sipërfaqësor, me çka përkeqësohet regjimi aktual i ujërave, shkaktohen procese të erozionit dhe kufizohet ose pamundësohet shfrytëzimi i ujërave. Kjo ndalesë eshtë masë për mbrojtje dhe mirëmbajtje të shtretërve natyrorë ose të regulluara të lumejve dhe brigjet e rrjedhave ujore, liqeneve dhe akumulimeve. Ndalimi i nxjerrjes të rerës, zhavorit dhe gurit është gjithashtu masë për mbrojtjen e zonave erozive[31]. Por me përjashtim, nxjerrja është e mundur si masë e regullimit në bazë të një licence ose në pajtim me kushtet në atë licencë. Licencimin e bën Ministria për mjedis jetesor dhe planifikim hapësinor. Me licencë caktohet lokacioni, sasia, mënyra, koha, mjetet dhe pajisjet për nxjerrje, ngarkim dhe transport të rërës, zhavorit dhe gurit,dhe ajo evidentohet në libër. Në zonën e rrjedhës të lumit të Lumit Vardar, që zë më tepër se 80% e resurseve të disponueshme të ujërave në teritorin e Maqedonisë, në periudhën deri vitin 2017 janë dhënë 66 licenca/vërtetime për menaxhim të ujit.

30. Neni 142 nga ligji për ujëra

31. Neni 131 dhe Neni 136

Regullimi dhe mirëmbajtja e ujërave sipërfaqësore me nxjerrjen e rërës, zhavorit dhe gurit, është logjike vetëm nëse paraprakisht subjekti i cili është përgjegjës për regullim, në pajtim me ligjin ka sjellë program për mbrojtje nga vërshimet. Me këto dokumente subjekti përgjegjës për regullim të shtretërve të rrjedhave të lumejve dhe brigjeve të ujerave sipërfaqësore duhet t'i percakton zonat erozive, zonat që jane të rezikuara nga erozioni dhe kufijtë e tyre. Gjithashtu, me programin dhe planin operativ, duhet që nxjerrja e rerës, zhavorit dhe gurit te jetë e përcaktuar si masë për mbrojtje nga veprimet e dëmshme, nga erozioni dhe regullim të burimeve. Këto detyrime ligjore nuk janë të plotësuara, dhe dhënia e licencave nuk është në pajtim me ligjin dhe sjell në përfundim faktin se lokacionet ku duhet të nxjerret rërë, zhavor dhe gurë nga ujërat sipërfaqësore nuk janë të planifikuara dhe nuk janë të dedikuara për arritjen e qëllimeve për regullim dhe mirëmbajtjen e shtretërve të lumejve[32].

Domethënë, aktivitetet për nxjerrjen e rerës, zhavorit dhe gurit nuk sigurojnë mbrojtje dhe përmirësim të regjimit të ujërave. Pjesa më e madhe e materialit të nxjerrur përdoret për shitje, derisa pjesa minimale për regullimin e shtretërve të lumejve . Gjatë kesaj, masa për mbrojtje nga nxjerrja joligjore nuk janë të përcaktuara. Kjo sjell deri në shkatërimin e shtretërve të lumejve (sidomos të lumit Vardar dhe degët të saja, ne rajonin e Zhelinës të Tetovës, fshati Siriçinë); në Crna Reka(Rosoman, fshatrat Manastirec, Trstenik, Sirkovo); në lumin Bregallnicë (në Karbinci të Shtipit, Pçinja në Konjarë të Epërme). Ky eksploatim joligjor është në favor të proceseve erodive dhe sjell deri në paraqitje të vërshimeve, me të e rrezikon shëndetin dhe pasurinë e popullatës.

32. Konstatimi gjindet në raportin përfundimtar për revision te kryer të suksesit „Efektivitet i politikave,masave dhe aktiviteteve gjatë eksploatimit te zhavorit dhe rërës në pellgun e Vardarit", 02 2018 00 02 Enti shtetëror për revision,Shkup,shkurt 2019,në dispozicion në faqenhttps://dzr.mk/Uploads/64_RU_Eksploatacija_chakal_pesok_od_vardarskiot_recen_sliv_2019_KOMPLET_REDUCE.pdf


3.

Zgjidhje alternative e politikave publike-program për menaxhim të qëndrueshëm të ujërave në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Masa 1:
Rishikim i strategjisë nacionale për ujërat

Masa 2:
Themelim i monitoringut operativ për regjione me rrjedha lumore

Masa 3:
Vendosje e qëllimeve për mjedis jetësor dhe miratim të programit të masave për arritjen e qëllimeve

Masa 4:
Krijim i planeve për menaxhim me rajonet me rrjedha lumore

Masa 5:
Sjellje e akteve nënligjore

Masa 6:
Sjellja e programit për furnizim me ujë të popullatës me sistem publik furnizimi

Masa 7:
Krijim i katastarit të shfrytëzuesve dhe ndotësve të ujit, evidentim i subjekteve që përdorin/ lëshojnë në ujëra pa licencë dhe sanksionim

Masa 8:
Legalizim i furnizimit që bëhet nëpermjet sistemeve lokale, rurale të furnizimit me ujë

Masa 9:
Rishiqim i ligjit për ujëra dhe akteve nënligjore në aspekt të lëshimit të licencave/ vërtetimeve për nxjerjen e rërës, zhavorit dhe gurrit nga shtrati i lumit dhe nga brigjet e ujrave siperfaqësore

Masa 1:
Rishikim i strategjisë nacionale për ujërat

Përshkrim i masës	Me strategjinë nacionale për ujëra duhet të përcaktohet politikë afatgjate për menaxhim të integruar dhe zhvillim të qëndrueshëm të ujërave nëpermjet plotësimit të nevojave të të gjithë shfrytëzuesve me ujë cilësor në sasi të mjaftueshme, shfrytëzim racional dhe ekonomik i ujit, mbrojtje e ujërave nga ndotja, mbrojtje dhe permirësim të truallit buzë brigjeve dhe mjediseve ujore dhe mbrojtje dhe zbutje të pasojave të ndikimit të dëmshem të ujërave dhe mungesa e ujit. Në strategji duhet të parashihen zgjidhje teknike dhe ekonomike për shfrytëzim racional të ujit, për mbrojtje të ujërave nga ndotja dhe mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujit, si dhe plan kohor për realizimin e tyre.
Rezultatet kryesore (indikator të gjendjes egzistuese):	Nuk ka bazë te qartë për nevojat e ardhsme për ujë, zgjidhjet teknike dhe ekonomike për shfrytezim racional të ujërave, mbrojtje të ujërave nga ndotja dhe mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave në pajtim me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe qëllime afatgjata për mjedisin jetësor dhe program për masa për realizimin e tyre; Plani hapësinor nuk i mer në konsideratë qëllimet të zhvillimit të qëndrushëm të resurseve ujore.
Rezultatet e pritura (indikator për rezultat/rezultat i pritur):	Përcaktim i qëllimeve afatgjata për mjedisin jetësor dhe program për masa për realizimin e tyre.
Kuantitative:	/
Kualitative:	Përcaktim i qëllimeve afatgjata për mjedisin jetësor dhe program për masa për realizmin e tyre.
Institucionet pergjegjëse:	MMJDHPH, Qeveria e RMV, Parlamenti i RMV.
Korniza kohore:	2020 – 2022

Buxheti indikues:	1. Punë ekspertësh:	53.100 euro
	2. Korniza kohore:	45.000 euro
	Gjithsej:	**98.100 euro**
***Themelim i monitoringut operativ i regjioneve me rrjedha ujore me:**	1. Pregaditje të programit për monitorim të trupave ujore, siperfaqësore dhe nëntokësore; dhe 2. Vendosje e monitorimit operativ; 3. Do të ketë implikime financiare shtesë për laboratore dhe pajisje që do të duhet të llogariten në varshmëri nga nevojat e caktuara në progame.	
Impakti teritorijal:	Teritori i Republikës së Maqedonisë së Veriut	

Masa 2:
Themelim i monitoringut operativ për regjione me rrjedha lumore

Përshkrim i masës	Përgaditje e programit për monitorim të trupave ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, dhe themelim të monitorimit operativ	
Rezultatet kryesore (indikatore të gjendjes aktuale):	Monitorimi bëhet nga ana e Drejtorisë për çështje hidro-meteorologjike(DPHM) të kualitetit dhe kuantitetit të ujërave brenda rrjetit hidro-meteorologjik për monitorim, por me pajtim me ligjin për çështje hidro-meteorologjike, kështu që nuk maten të gjitha parametrat për kualitet në pajtim me Ligjin per ujëra, nuk ka monitorim të vazhdueshëm operativ të substancave prioritare; Enti Hidrobiologjik/Fakulteti matematiko-natyror bëjne monitorim në bazë proektuese, Instituti për shëndet publik bën monitorim të ujërave të pije dhe për banjë.	
Rezultate të pritura (indikatorë të rezultatit/rezultat i pritur)	Identifikim dhe paraqitje të presioneve të shumta dhe ndikimeve mbi gjendjen e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë të shkaktuara nga aktivitetet njerëzore; informata dhe kartografi të zonave te regjistruara të mbrojtura; informacione dhe kartografi për aktivitetet për monitorim të gjendjes të ujërave dhe programet për monitorim; lista e qëllimeve për mjedisin jetësor për çdo trup ujor në rrjedhën lumore, duke i përfshirë dhe informatat për leshimet , shënimin e ujërave artificiale dhe trupave ujore të ndryshuara me forcë.	
Kuantitative:	Sjellje dhe operativë e 4 programeve për monitorim për çdo rajon të rrjedhave lumore.	
Kualitative:	Determinim të kualitetit e të gjithë ujërave në teritor të shtetit. Themelim të qëlimeve të mjedisit jetësor për çdo trup ujor sipas tipologjisë.	
Institucione drejtpërdrejtë përgjegjëse:	MMJDHPH, DHM; ISHB, Qeveria e RMV	
Afati kohor:	2020 – 2021	
Buxheti indikativ:	1. Punë eskpertësh:	106.200 euro
	2. Shpenzime për teren për analizën e kualitetit të ujit:	3.667 euro
	Gjithsej:	**109.867 euro**
Impakti teritorijal:	Teritori i RMV	

Masa 3:
Vendosje e qëllimeve për mjedis jetësor dhe miratim të programit të masave për arritjen e qëllimeve

Përshkrim i masave	Gjendja ekologjike percaktohet në përputhje me elementet kualitative biologjike, hidromorfologjike dhe fiziko-kimike. Pika referuese janë parametrat biologjike të ujërave të cilat kanë pësuar ndikim minimal njerëzor. Në përputhje me këte, gjendja ekologjike mund të jetë e lartë, e mirë, e mesme, e ulet ose e keqe, varësisht nga ajo sa kanë pasur njerëzit ndikim mbi kualitetin e ujit. Gjendja e mirë kimike, nga ana tjetër, arrihet kur në një trup të caktuar ujor nuk ka koncentrim të materieve ndotëse, me të cilat do të ishin tejkaluar standardet për kualitet të mjedisit jetësor. Gjendja e mirë kimike arrihet me ulje progresive të ndotjes të trupave ujore, posaqërisht nga materiet e rezikshme. Menaxhimi me ujërat nëntokësore duhet të siguron arritje e gjendjes të mirë kimike dhe kuantitative. Për ujërat nëntokësore vlejnë standard tjera. Gjendja e mirë kuantitative është e përmbushur kur pompimi i ujërave nëntokësore është më i vogël se mbushja e sërishme natyrore dhe kur egziston ujë të mjaftueshëm për ekosistemet tokësore që janë të varura nga ujërat nëntokësore. Gjendja e mirë kimike, arrihet kur plotësohen vlerat e dhëna të kufizuara, me të përmbajtja e tyre nuk ka ndonjë ndikim negativ të konsiderueshëm. Qëllimi global është të ketë plan- i cili në fakt paraqet plan të veprimit dhe rishikim të kualiteteve të dëshiruara të ujërave dhe të shpërndarjes të ujit për shfrytëzim. Plani gjithashtu elaboron si të arrihen dhe të menaxhohen këto qëllime. Duhet tju mundësohet edhe administratës edhe publikut ti konsultojnë këto plane dhe në këtë mënyrë të informohen për qëllimet e planit dhe për mjetet për realizmin e tyre.
Rezultatet kryesore (indikatorë të gjendjes aktuale):	Qëllimet e mjedisit jetësor për trupat ujore nuk janë të caktuara. Nuk ka program të masave për arritje të qëllimeve.
Rezultate të pritura (indikatore të rezultatit/rezultat i pritur)	Përcaktimi e trupave ujore. Caktim e qëllimeve për mjedisin jetësor dhe miratim të programit të masave për arritje të qëllimeve për të gjitha ujërat/trupat ujore.
Kuantitative:	Caktim i qëllimeve të mjedisit jetësor dhe miratim i programit të masave për arritjen e qëllimeve të të gjitha ujërave në të gjitha nga katër rajonet të rrjedhave lumore. Arritje ose rruajtje ”gjendjes së mirë” në gjitha ujërat, ato nentokësore dhe sipërfaqësore.

Kualitative:	Caktim i qëllimeve në lidhje me kualitetin e ujit në çdo trup ujor veçmas, brenda rrjedhës përkatëse lumore. Arritje të gjendjes të mirë ekologjike të trupave ujore dhe ekosistemeve ujore, si dhe ekosistemve të varura nga uji dhe gjendjes të mirë kimike dhe potencijalit të mirë ekologjik të ujit në liqenet artificiale dhe trupave ujore të ndryshuara me forcë. Çdo shrytëzim i ujit dhe lëshimeve në ujë, truallin buzë brigjeve dhe mjedise ujore bëhet në bazë të licencës në përputhje me kriteret për kualitet të ujit dhe qëllimet të mjedisit jetësor.	
Institucione përgjegjëse:	MMJDPH, Qeveria e RMV	
Afati kohor:	2021 – 2022	
Buxheti indikativ	1. Punë ekspertësh:	26.550 euro
	Gjithsej:	**26.550 euro**
Impakti teritorijal:	Teritori i RMV	

Masa 4:
Krijim i planeve për menaxhim me rajonet me rrjedha lumore

Përshkrim i masës	Bërje e planeve për menaxhim me rajonet me rrjedha lumore(PMRL). Në teritorin e Maqedonisë me ligjin janë caktuar katër rajone të rrjedhave lumore, të cilat sipas njësise të përgjithsme hidrografike mund të kualifikohen me karakter ndërkombëtar,dhe atë : 1. Rrjedha e lumit Vardar; 2. Rrjedha e lumit Strumica; 3. Rrjedha e lumit Drini i Zi dhe 4. Rrjedha e lumit Morava Jugore.
Rezultate kryesore (indikator të gjendjes aktuale):	Pregaditja e PMRL bëhet me ndihmë ndërkombëtare. Deri tani tërësisht janë pregaditur , por sjanë miratuar Planet për menaxhim me rrjedhën të lumit Strumica; Plani për menaxhim me një pjesë të rrjedhës të lumit Vardar, nënrrjedhat Bregalnica, Plani për menaxhim me pjesë të rrjedhës të lumit Drini i Zi, nënrrjedha në liqenin e Prespës dhe liqenit të Ohrit.
Rezultate të pritura (indikator të rezultatit/rezultat i pritur)	Bërje e planit për menaxhim me çdo rajon të rrjedhës lumore. Dokumenti duhet të përmban përshkrim të karakteristikave të rrjedhës lumore; identifikim dhe prezentim të presioneve dhe ndikimeve domethënëse në gjendjen të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të shkaktuar nga aktivitetet njerëzore; informata dhe prezentime kartografike të zonave të regjistruara të mbrojtura; informata dhe prezentime kartografike për aktivitetet për monitorim të gjendjes të ujërave dhe programeve për monitorim; listë e qëllimeve për mjedisin jetësor për çdo trup ujor në rrjedhën lumore, duke i përfshirë dhe informatat për lëshimet, përcaktimin e ujërave sipërfaqësore artificiale dhe ato të ndryshuara me forcë. Informatat i tregojnë masat e planifikuara dhe të marra për permirësim të kualitetit të ujërave dhe arritje të qëllimeve për mjedisin jetësor; analizë ekonomike për shfrytëzimin e ujërave, duke përfshirë dhe raport për përdorimin e parimit "shfrytëzuesi paguan"; program të masave për arritjen e qëllimeve të mjedisit jetësor; programe më të detajuara dhe plane për menaxhim me ujërat të rrjedhave lumore dhe nënrrjedhat; program për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave dhe masat themelore për mbrojtje nga vërshimet; prezentim të aktiviteteve dhe rezultateve nga pjesëmarrja e publikut gjatë pregaditjes të planit; listë e organeve dhe institucioneve përgjegjëse për ujërat në rrjedhën lumore; mënyra në të cilën informatat dhe dokumentet në lidhje me perpunimin dhe implementimin e planit janë të disponueshëm për publikun; realizim i detyrimeve të marra me marëveshje ndërkombëtare që vlejnë për menaxhimin me ujërat, të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut.
Kuantitative:	Sjellje e katër planeve dhe atë për: 1. Rrjedhjen e lumit Vardar; 2. Rrjedhjen e lumi Strumica; 3. Rjedhjen e lumit Drini i Zi dhe 4. Rrjedhjen e lumit Morava Jugore.

Kualitative:	Percaktim i qëllimeve në lidhje me kualitetin e ujit për çdo trup ujor veçmas, brenda rrjedhës lumore perkatëse. Arritje ose rruajtje e "gjendjes të mirë" në të gjitha ujërat. Siperfaqësoret dhe nëntokësoret. Arritje e gjendjes të mirë ekonomike të trupave ujore dhe ekosistemeve ujore, si dhe ekosistemeve të varura nga ujërat dhe gjendje e mirë kimike dhe potencijal të mirë ekologjik të ujit në liqenet artficiale dhe trupave ujore të ndryshuara me forcë. Çdo shfytëzim i ujërave dhe lëshimit të ujërave, në truallin buzë brigjeve dhe ne mjediset ujore, bëhet në bazë të licencës në përputhje me kriteret për kualitet të ujit dhe qëllimet të mjedisit jetësor.	
Institucione përgjegjëse:	MMJDPH, Qeveria e RMV	
Afati kohor:	2021 – 2022	
Buxheti indikativ:	1. Punë ekspertësh:	141.600 euro
	2. Organizim të katër debateve publike për shkak të inkuadrimit të publikut ekspert në përpunimin e planit:	20.000 euro
	Gjithsej:	**161.600 euro**
Impakti teritorijal:	Impakti teritorijal: Teritori i RMV	

Masa 5:
Sjellje e akteve nënligjore

Përshkrim i masës	Sjellje e akteve nënligjore për të cilën ka bazë ligjore nga Ligji për ujërat	
Rezultatet kryesore (indikator të gjendjes aktuale):	Nga gjithsej 106 baza ligjore në Ligjin për ujëra për sjelljen e akteve nënligjore me të cilat duhet të sigurohet implementim të Ligjit dhe arritje e qëllimeve të ligjit, për 52 nuk janë sjellur akte nënligjore. Shumica e tyre janë për qëllimet e mjedisit jetësor dhe vlerat e kufizuara të lëshimeve për ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore, zonat e mbrojtura, leshimet e lejuara, mbrojtje nga veprimet e dëmshme të ujërave, monitorim i ujërave dhe sistem informativ, si dhe mënyra e mbajtjes të evidencës dhe mënyra e llogaritjes të njësisë së dëmit. Me këtë, të drejtat dhe detyrimet të parapara me Ligjin për ujëra nuk mund të implementohen në mënyrë adekuate.	
Rezultate të pritura (indikator të rezultatit/rezultat i pritur)	Implementimi i Ligjit për ujëra në kuptim të mbrojtjes të ujërave: qëllimeve të mjedisit jetësor dhe vlerave të kufizuara të emisioneve për ujëra sipërfaqësore dhe nëntokesore, zonat e mbrojtura, leshimet e lejuara, mbrojtje nga ndikimet e dëmshme të ujerave, monitorim i ujerave, sistem informative, mbajtje e evidencës dhe mënyrë e llogaritjes të njësisë të dëmit.	
Kuantitative:	Janë sjellur 52 dispozita nënligjore për 52 baza ligjore nga Ligji për ujëra.	
Kualitative:	Përmbushje e qëllimeve të ligjit	
Institucione përgjegjëse:	MMJDPH, Qeveria e RMV	
Afati kohor:	2020 - 2021	
Buxheti indikativ:	1. Punë ekspertësh:	47.700 euro
	Gjithsej:	**47.700 euro**
Impakti teritorijal:	Teritori i RMV	

Masa 6:
Sjellja e programit për furnizim me ujë të popullatës me sistem publik furnizimi

Përshkrim i masës	Marrja e masave të duhura për zhvillim dhe mirëmbajtje të sistemit efikas dhe ekonomik të furnizmit me ujë për pije në sasi te duhura dhe sipas kërkesave deri te gjithë shfrytëzuesit ligjor.
Rezultate kryesore(indikator të gjendjes aktuale):	11,1 % të numrit të përgjithshëm të amvisërive individuale nuk kanë akses deri në ujë të pijshëm. Në nivel shtetëror ka dallime domethënëse në mbulimin aktual të shërbimeve për furnizim me ujë nëpër regjione. Mbulim më të madh me menaxhim dhe percjellje të regullt- furnizim qendror është vërejtur në Rajonin e Shkupit (rreth 91%), dhe mbulim më të ulët është regjistruar në rajonin e Pollogut me Rajonin Verilindor dhe Rajonin Jugoperendimor(66 deri 75 %).
Rezultatet e pritura (indikator të rezultatit/rezultat i pritur)	Furnizim me ujë për pije nga ujësjellsi publik deri te gjith amvisëritë individuale në teritorin e shtetit.
Kuantitative:	Numër i amvisërive që furnizohen nga sistemi publik për furnizim me ujë.
Kualitative:	E drejta e njeriut për ujë është e domosdoshme për jetesë në kufi të dinjitetit njerezor. Numër më i madh i amvisërive në lagje rurale me pak popullatë që me ujë të pijshëm furnizohen nga ujësjellsi publim. Ujë i sigurt dhe i regullt në aspektin shëndetsor dhe për nevoja për amvisëri në sasi të mjaftueshme.
Institucione përgjegjëse:	Vetëqeverisja lokale
Afati kohor:	2021 – 2023

Buxheti indikativ:	1. Punë ekspertësh:	53.100 euro
	2. Debat publik për programin:	10.000 euro
	3. Metodologjia për përpunimin e programeve komunale:	21.150 euro
	4. Përpunim i programeve komunale për furnizim me ujë:	38.500 euro
	Gjithsej:	**122.750 euro**
Impakti teritorijal:	Teritori i RMV	

Masa 7:
Krijim i katastarit të shfrytëzuesve dhe ndotësve të ujit, evidentim i subjekteve që përdorin/ lëshojnë në ujëra pa licencë dhe sanksionim

Pershkrim i masës	Krijim i katastarit të shrytëzuesve dhe ndotësve të ujit, evidentim i subjekteve qe shrytëzojnë/lëshojnë ujë pa leje dhe sanksionim.
Rezultatet kryesore (indikator të gjendjes aktuale):	Lëshimi i ujërave të zeza nga industria dhe xehtaria, mbi të cilat pas përdrorimit nuk u është berë asnjë trajtim, bëhet në marrës të caktuar. Si marrës të ujerave të zeza paraqiten: trualli, kanalizimi, rrjedhat e ujit, akumulimet dhe liqenet. Në vitin 2017, nga ujërat totale të lëshuara nga industria dhe xehtaria, o,3% janë leshuar në kanalizim, dhe 99.7% në rrjedha ujore. Ndërmarjet publike komunale leshojnë në marrësit ujëra të zeza komunale të papastruara. E ulët është përqindja e licencave të lëshuara për shfrytezim të ujërave për një qëllim të caktuar, si dhe përqindja e licencave të dhëna për lëshim në marrës.
Rezultate të pritura(indikator të rezultateve/rezultat i pritur)	Çdo shrytëzim i ujit bëhet në bazë të licencës dhe në mënyrë që i konvenon qëllimit dhe kushte të caktura në licencë. Çdo leshim i plotëson kriteret (vlerat të kufizuara për lëshim për parametra si dhe qëllimet për çdo trup ujor). Bartësit e licencës për shfytëzim/lëshim në përputhje me ligjin paguajnë tarifë për shfrytëzim/leshim në ujë. Mjetet e mbledhura ne buxhetin shtetëror shrytëzohen për qëllime të përcaktuara me ligjin.
Kuantitative:	Numri i licencave të lëshuara për shfytëzim të ujit. Numri i licencave të lëshuara për lëshim në uj.
Kualitative :	Implementim i Planeve për menaxhim me rajonet me rrjedhje lumore. Realizim i qëllimeve për mjedisin jetësor për çdo trup ujor/banim buzë bregut/zonë e mbrojtur. Ulje e lëshimeve të materieve ndotëse në ujëra.
Institucione përgjegjëse:	MMJDPH, Inspektorati shtetëror për mjedis jetësor- inspektor i ujrave
Afati kohor:	2021 – 2022

Buxheti indikativ:	1. Angazhim i kompanisë(ve) për mbledhje të të dhënave për ndotësit e ujërave dhe përpunim të zgjidhjes softuerike për katastar të ndotësve:	350.000 euro
	2. Punë ekspertësh:	6.750 euro
	3. Mirëmbajtje softueri(për një vit):	60.000 euro
	4. Shpallje publike e katastarit të ndotësve:	5.000 euro
	Gjithsej:	**381.750 euro**
Impakti teritorijal: Teritori i RMV	Teritori i RMV	

Masa 8:
Legalizim i furnizimit që bëhet nëpermjet sistemeve lokale, rurale të furnizimit me ujë

Përshkrim i masës	Legalizim i furnizimit që bëhet nëpermjet sistemeve lolale, rurale për furnizim dhe sigurim të sigurisë të ujit që furnizohet nëpërmjet sistemeve të atij lloji.
Rezultatet kryesore (indikator të gjendjes aktuale):	Në teritor të shtetit, 10% te popullatës furnizohet me ujë të pijshëm dhe për nevoja tejra për amvisëritë nëpërmjet sistemeve lokale, rurale për furnizim me të cilat udhëheqin bashkesitë locale ,dhe 11% kanë furnizim me uj personal privat. Sistemet me të vogla ujësjellëse që janë ndërtuar në lagjet rurale janë kryesisht të ndërtuara nga vetë qytetarët me anë të vetëfinansimit ose me kombinim me donacione dhe ato janë ende në funkcion për furnizim me ujë të popullsisë lokale. Furnizimi me ujë nepërmjet këto sisteme ndryshon edhe në raport me kualitetin, dhe në lidhje me kuantitetin e ujit. Bashkesitë vendase gjegjësisht bashkesitë urbane në shtet nuk kane statut të personave ligjorë, dhe menaxhiminn me sistemin e furnizimit me ujë e bëjnë në mënyrë joformale. Nga kontrollet sanitaro higjienike të bëra për korrektësi shëndetsore të ujit për konsum nga ana e njeriut nga këto sisteme për furnizim, 27% të mostrave kanë qenë të paregullta në aspekt të parametrave fiziko-kimike për sigurine e ujit, dhe 28,6% kanë qenë të paregullta në aspekt të parametrave mikrobiologjike.
Rezultate të pritura (indikatorë të rezultatit/rezultat i pritur)	Mundësim të ujit të pijshëm të sigurt qe furnizohet nepërmjet sitemeve joformale, lokale, rurale për furnizim me ujë. Mundësim të licencave të duhura për shrytëzim të ujit nëpërmjet dhënësit të shërbimit publik, siç është e përcaktuar me të drejtën pozitive. Sigurim i monitorimit të regullt të kualitetit të ujit për pije në sistemet joformale të furnizimit me ujë.
Kuantitative:	Numër të sistemeve joformale, pronësia dhe menaxhimi operativ i të cilëve është percjellur në dhënës të shërbimeve në përputhje me ligjin.
Kualitative:	Sigurim i sigurisë të ujit që sjellet nëpërmjet këto sisteme.
Insitucionet pergjegjëse:	Vetëqeverisja lokale, Qeveria e RMV
Afati kohor:	2021 – 2022

Buxheti indikativ:	1. Angazhim i kompanisë për mbledhjen e të dhënave:	60.000 euro
	2. Punë ekspertësh:	35.400 euro
	Gjithsej:	**95.400 euro**
Impakti teritorijal:	Teritori i RMV	

Masa 9:

Rishiqim i ligjit për ujëra dhe akteve nënligjore në aspekt të lëshimit të licencave/vërtetimeve për nxjerjen e rërës, zhavorit dhe gurrit nga shtrati i lumit dhe nga brigjet e ujrave siperfaqësore

Përshkrim i masave	Ndryshime dhe plotësime të Ligjit për ujëra, sjellja e akteve nënligjore
Rezultate kryesore (indikator të gjendjes aktuale):	Egzistojnë dobësi në regulativën ligjore dhe akteve nënligjore për mirëmbajtjen dhe regullimin e ujërave sipërfaqësore, që sjell deri te nxjerrja joligjore e materijalit. Licencimi nuk është në pajtim me ligjin dhe arrihet deri në konkludim se lokacionet në të cilat nxjerret rerë, zhavor dhe gurë nga ujërat siperfaqësore nuk janë të planifikuara dhe nuk kanë për qëllim regullimin dhe mirëmbajtjen e shtretërve të lumejve. Aktivitetet per nxjerrjen e rerës, zhavorit dhe gurit nuk mundësojnë mbrojtje dhe permirësim te regjimit të ujerave. Pjesa më e madhe e materijalit të nxjerrur shfrytezohet per shitje, derisa pjesa më e vogël per regullimin e shtretërve të lumejve. Gjatë kësaj, masa për mbrojtje nga nxjerrja joligjore nuk janë të përcaktuara.
Rezultate të pritura (indikator të rezultatit/rezultat i pritur)	Suksesi i politikave për regullim dhe mirëmbajtje të shtretërve të lumejve dhe brigjeve të ujrave siperfaqësore. Krijim i kushteve themelore per planifikim preciz të nevojës për regullim dhe mirëmbajtje të shtretërve të lumejve dhe brigjet e ujërave supërfaqësore. Nxjerje e materijalit si masë e regullimit të shtretërve dhe brigjeve dhe sanksionim për nxjerrje të materijalit për qëllime komercijale . Percaktim të subjekteve të cilat munden të bëjnë regullimin, mbajtjen e evidencës të licencave të lëshuara/vërtetime për nxjerrjen e rerës, zhavorit dhe gurit, regullim i mënyrës të shitjes të materijalit të nxjerrur tepricë dhe sigurim i konkurencës dhe transparencës të procesit. Fuqizim i mbikqyrjes inspektive dhe profesionaliste.
Kuantitative:	Numër i licencave të dhëna/vërtetimeve te dhëna
Kualitative:	Sukses i politikave për regullim dhe mirëmbajtje te shtretërve të lumejve dhe brigjeve të ujerave sipërfaqësore.
Institucionet përgjegjëse:	MMJDPH; Qeveria e RMV.
Afati kohor:	**2021 –2022**

Buxheti indikativ:	1. Punë ekspertësh:	42.300 euro
	Gjithsej:	**42.300 euro**
Impakti teritorijal:	Teritori i RMV	

Implikacione totale financiare:	**1.086.017 euro**
1. Punë ekspertësh:	512.700 euro
2. Shpenzime të ndryhme në teren:	63.667 euro
3. Përpunim i metodologjive dhe programeve:	59.650 euro
4. Angazhim i kompanive për mbledhje të të dhënave për ndotës dhe përpunim dhe mirëmbajtje e zgjidhjes softuerike për katastar të ndotësve:	370.000 euro
5. Promovime të strategjive, debateve publike dhe ngritjes të vetëdijes publike	80.000 euro

Implikimet finaciare me ndjeshmëri gjinore

Shpenzimet nën numër 1 dhe 3 janë me ndjeshmëri gjinore. Me supozim se gjatë angazhimit të ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar, dhe përpunimit të metodologjive dhe programeve do të mbahet llogari që më së paku 40% të ketë përfaqësim nga secila nga gjinitë, me qëllim që implikimet sensitive gjinore fiskale janë 572.350 euro, nga të cilat me së paku 228.940 euro duhet të jenë shpenzime për secilën gjini.

Për llogaritjen të detajuar, shih Shtojcën 1: Llogaritje e implikimeve finansiare të detajuara me shpjegime për çdo masë veçmas 1-9.


4.

Përfundimi dhe referencat

Dispozitat e legjislacionit për ujëra janë të harmonizuara me praktikat më të mira europjane dhe vendosin detyrime të qarta dhe koncize për mbrojtjen e ujërave dhe mekanizmave që janë në dispozicion për mbrojtjen e ujërave si medium i mjedisit jetësor. Përpos nevojës të definuar për harmonizim të mëtutjeshëm të legjislacionit, problem kryesor në sferën e ujërave paraqet mosrealizimi i detyrimeve ligjore nga më tepër organe të aparatit shtetëror. Në këtë aspekt, masat e propozuara intervente janë të drejtuara kah krijimi i kushteve për implementim të dispozitave ligjore, me çka do të mundesohet menaxhim i integruar i ujërave në nivel nacional.

Masa	Sintezë koncize e rezultateve kryesore	Rekomandime	Bartësit kryesor të politikave	Tjera palë të interesuara	Buxhet indikativ
Masa 1	Nuk ka bazë të qartë strategjike për menaxhim të qëndrueshëm me ujërat.	Rishikim i strategjisë nacionale për ujëra	MMJDP,Qeveria, Kuvendi	MBPEU,MTL,MVL,NVL Shfrytëzues të ujit, OJQ	98.100
Masa 2	Nuk ka të dhëna të sakta për gjendjen e ujërave nga laboratore të akredituara.	Pregaditje të programit për monitorimtë trupave ujore,siperfaqësore dhe nëntokësore dhe themelim i monitorimit operativ	MMJDP,Qeveria, ELS	ISHP, AUV,DHM,FSHMN	109.867
Masa 3	Nuk ka qëllime të vendosura për mjedisin jetësor për trupat ujore Nuk ka program të masave për arritje të qëllimeve.	Vendosje e trupave ujore. Percaktim të qëllimeve të mjedisit jetësor dhe miratim të programit të masave për arritjen e qëllimeve për të gjithe ujërat në çdo rajon të rrjedhës lumore.	MMJDP, Qeveria	Këshilli për menaxhim me rrjedha lumore	26.550
Masa 4	Nuk ka dokument planifikues i cili paraqet bazë për licencim.	Sjellje të planeve për menaxhim me katër rrjedhat në teritorin e shtetit.	MMJDP, Qeveria	Këshilli për menaxhim me rrjedha lumore	161.600
Masa 5	Mungesë e akteve që janë parakusht për implementimin të Ligjit.	Sjellje e akteve nënligjore	MMJDP, Qeveria	MSH, MBPEU MTL, MVL, NVL, Këshilli për menaxhim me rrjedhat lumore	47.700
Masa 6	Zhvillim dhe mirembajtje të sistemit efikas dhe ekonomik për furnizim me ujë për pije të sigurt nga aspekti shëndetësor në sasi të mjaftueshme.	Sjellje e programit për furnizim me ujë të popullatës me sistem publik për furnizim	MMJDP,Qeveria, Kuvendi	MSH, MBPEU MTL, MVL, NVL, Këshilli për menaxhim me rrjedhat lumore	122.750
Masa 7	Mungesë e evidencës te presioneve në trupat ujore. Tolerim të leshimeve joligjore/ shfytëzim,tarifat janë me të larta në NVL që e pastrojnë ujin	Katastar i shrytëzuesve dhe ndotësve të ujit, evidentim të subjekteve që përdorin/lëshojnë në ujë pa licencë dhe sanksionim	MMJDP, Qeveria	MSH, MBPEU MTL, MVL, NVL, Këshilli për menaxhim me rrjedhat lumore	381.750
Masa 8	Uj i pasigurt për pije i cili furnizohet nëpermjet sistemeve joformale lokale,rurale për furnizim me ujë. Mungesa e licencave për shfrytëzim të ujërave. Sigurim të furnizimit me ujë nepërmjet dhënës ligjor të shërbimeve publike. Mungesa e monitorimit të regullt të kualitetit të ujit të pijshëm në sistemet joformale për furnizim me ujë.	Legalizim të furnizimit me ujë që bëhet nëpermjet sistemeve lokale,rurale dhe sigurim të sigurisë te ujit që sjellet me ato sisteme.	MJDPH, Qeveria, MSH, MTB	MVL, NVL, NKP	95.400
Masa 9	Mirëmbajtje dhe regullim i përshtatshëm i ujërave sipërfaqësore. Germim joligjor i materijalit.	Ndryshime dhe plotësime të Ligjit për ujëra, sjellja e akteve nënligjore	MMJDP,Qeveria, Kuvendi	Ujësjellsi AD, NVL, ISHMJ	42.300
GJITHSEJ:					**1.086.017**

Shkurtesa:

AUV	Agjencioni për ushqim dhe veterinari
ISHMJ	Inspektorati shtetëror për mjedis jetësor
NVL	Njësitë për vetëqeverisje lokale
NPK	Ndermarje komunale publike
MMJPH	Ministria e mjedisit jetesor dhe planifikimit hapesinor
MSH	Ministria e shëndetësisë
MBPEU	Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujit
MVL	Ministria për vetëqeverisje lokale
MTL	Мinistria e transportit dhe lidhjeve

Shtojcë

Shtojca 1: Llogaritje e implikimeve finaciare të detajuara me shpjegime për çdo masë veçmas 1-9.

MASA 1: Rishikim i strategjisë nacionale për ujëra 2011 – 2041				
	numër	Angazhim në ditë*	Pagesë ditore mesatare në euro	Gjithsej mjete të duhura në euro
Ekspert vendor	2	90	120	21,600
Ekspert ndërkombëtar	1	90	350	31,500
**Promovim i strategjisë/ kampanjës për ngritjen e vetëdijes publike për mbrojtjen e ujërave				45,000
				98,100

Shpjegim shtesë për llogaritjen:

- Një ekipë nga konsultant ndërkombëtar dhe dy ekspert vendor
- *Kohëzgjatja e punës 3 muaj
- Pagat për të punësuarit në institucione nuk i llogaritim si shpenzim shtesë se janë të siguruara nga buxheti
- **Shpenzimet e vlerësuara për promovim do të përfshinë: pregaditje për shtypje të materijalit promovues, mbajtje e konferencës njëditore me debat në lidhje me temën,shpenzime për marrjen me qera të sallës, ketering, zërim etj.

MASA e 2: Vendosje e monitorimit operativ për rajone me rrjedha lumore				
	numër	Angazhim në ditë*	Pagesë ditore mesatare në euro	Gjithsej mjete të duhura në euro
Ekspert vendor	4	90	120	43,200
Ekspert ndërkombëtar	2	90	350	63,000
Shpenzime në teren për analizën e kualitetit				3,667
				109,867

Shpjegim shtesë për llogaritjen:

- Dy ekipe nga dy ekspert vendor dhe një eksper t ndërkombëtar të përpunojnë katër plane
- *Angazhimi kohor nga 1.5 muaj në plan
- Pagat e të punësuarve në institucionet nuk i llogaritim si shpenzim shtesë sepse janë siguruar më nga buxheti
- Shpenzime në teren dhe shpenzime për analizën e mostrave të ujit(mikrobiologjike,kimike dhe metale të rënda): 10 pika nga çdo regjion të rrjedhës, distancë mesatare 125km në drejtim, shpenzim mesatar të derivatit 7 litra në 100 km dhe çmimi për një analizë laboratorike 20 euro

MASA e 3: Përcaktim i qëllimeve për mjedisin jetësor dhe miratim i programit me masa për arritjen e qëllimeve

	numër	Angazhim në ditë*	Pagesë ditore mesatare në euro	Gjithsej mjete të duhura në euro
Ekspert vendor	2	45	120	10,800
Ekspert ndërkombëtar	1	45	350	15,750
				26,550

Shpjegim shtesë për llogaritjen:

- *Koha e angazhimit 1.5 muaj
- Pagat e të punësuarve në institucione nuk i llogaritim si shpenzim shtesë sepse ato janë më të siguruara me buxhet

MASA e 4: Sjellje e planeve për menaxhim me regjionet me rrjedhje lumore

	numër	Angazhim në ditë*	Pagesë ditore mesatare në euro	Gjithsej mjete të duhura në euro
Ekspert vendor	8	60	120	57,600
Ekspert ndërkombëtar	4	60	350	84,000

Organizim i katër debateve publike për kyqjen e ekepsertëve në përpunim të planit	4			20,000
				161,600

Shpjegim shtesë për llogaritjen:

- Katër ekipe nga dy ekspertë vendor dhe një ekspert ndërkombëtar
- *Kohëzgjatja e punës, nga dy muaj për çdo plan
- Pagat e të punësuarve në institucione nuk i llogaritim si shpenzim shtesë sepse ato janë më të siguruara me buxhet
- Shpenzimet e llogaritura për debate publike janë për marrje të hapësirave dhe shpenzime materiale për organizim të debatit. Planifikohet edhe nga një debat publik për çdo plan për çdo rajon me rrjedha.

MASA 5: Sjellja e planeve për menaxhim me rajonet me rrjedha lumore				
	numër	Angazhim në ditë*	Pagesë ditore mesatare në euro	Gjithsej mjete të duhura në euro
Ekspert vendor	3	45	120	16,200
Ekspert ndërkombëtar	2	45	350	31,500
				47,700

Shpjegim shtesë për llogaritjen:

- Dy ekspertë ndërkombëtar dhe tre ekspertë vendor do të punojnë me të punësuarit nëpër institucione në zhvillim të regullores nënligjore
- *Angazhim kohor nga 1.5 muaj

MASA 6: Sjellje e programit për furnizim me ujë të popullatës me sistem publik të furnizimit				
	numër	Angazhim në ditë*	Pagesë ditore mesatare në euro	Gjithsej mjete të duhura në euro

Ekspert vendor	2	90	120	21,600
Ekspert ndërkombëtar	1	90	350	31,500
Debat publik gjatë pregaditjes të Programit				10,000
Ekspert vendas për metodologjinë e përpunimit të programeve komunale	1	45	120	5,400
Ekspert ndërkombëtar për metodologjinë e përpunimit të programeve komunale	1	45	350	15,750
Përpunim i programeve komunale për furnizim me ujë				38,500
				122,750

Shpjegim shtesë për llogaritjen:

- Një ekipë nga konsultant ndërkombëtar dhe dy ekspert vendor për përpunim të Programit
- Një ekipë nga ekspert vendas dhe ndërkombëtar të përpunojnë Metodologji për përpunim të programeve komunale
- *Në afat kohor nga tre muaj të punojnë për Programin dhe 1.5 muaj të punojnë në Metodologjinë
- Pagat e të punësuarve në institucione nuk i llogaritim si shpenzim shtesë sepse janë më të siguruara në buxhet
- Një ose dy debate publike gjatë pregaditjes të vetë Programit, dhe shtypje eventuale të fletushkave pas sjelljes të Programit
- Shpenzimet për përpunim të programeve komunale i referohen të gjithë komunave në RMV, përfshijnë shpenzime eventuale materijale minimale, sespe është paraparë që programet komunale ti pregaditin vetë komunat me metodologji të përcaktuar

MASA 7: Krijim i katastarit të shfrytëzuesve dhe ndotësve të ujit, evidentim i subjekteve që shrytezojnë/lëshojnë në ujë pa licencë dhe sanksionim				
	numër	Angazhim në ditë*	Pagesë ditore mesatare në euro	Gjithsej mjete të duhura në euro
Kompani lokale për mbledhje të të dhënave për ndotës të ujërave	1	270		150,000
Kompani lokale për përpunim të zgjidhjes softuerike për katastar të ndotësve	1	180		200,000
Ekspert vendor	1	45	150	6,750
Mirëmbajtje të softuerit				20,000
Shpallje publike të katastarit të ndotësve				5,000
				381,750

Shpjegim shtesë për llogaritjen:

- Kompani lokale duhet të bën mbledhje administrative dhe në teren të të dhënave për gjithë ndotësit e ujërave në teritor të RMV me qëllim që të behet një bazë e të dhënave
- Kompani lokale duhet ta dizajnon dhe të zhvillon aplikacionin softuerik për katastar të ndotësve dhe të sigurojë link me tjera zgjidhje softuerike nga relevantet
- *Angazhimi kohor i kompanive dhe ekspertit-një konsultant vendor ti zhvillon biznis-proceset në formë të procedurave, kush është kompetent të dorëzon të dhëna në katastarin, në çfarë forme, privilegjet dhe qasje në softuer dhe tjerë
- Pagat e të punësuarve në institucione nuk i llogaritim si shpenzim shtesë sepse janë më të siguruara në buxhet
- Prezentim publik të aplikacionit softuerik dhe përfitimet nga katastari i ndotësve
- Shpenzimet për mirëmbajtje janë në nivel vjetor dhe ato quhen si shpenzim i vazhdueshëm i institucionit

MASA 8: Legalizim i furnizimit me ujë që behet nëpermjet sisteme lokale,rurale të furnizimit me ujë				
	numër	Angazhim në ditë*	Pagesë ditore mesatare në euro	Gjithsej mjete të duhura në euro
Kompani lokale për mbedhjen e të dhënave	1	365		60,000
Ekspert vendor	2	60	120	14,400
Ekspert ndërkombëtar	1	60	350	21,000
				95,400

Shpjegim shtesë për llogaritjen:

- Kompani lokale e cila do të bën regjistrim të të gjitha sistemeve ujësjellëse lokale, rurale të cilat duhet të jenë subjekt i legalizimit me gjitha karaketrisitkat e tyre(numri i popullatës, gjatësia në metra, mënyra e përpunimit të sistemit furnizues etj)
- Ekipë nga dy ekspert lokal dhe një ndërkombëtar për përpunimin të propozim-zgjidhjeve për legalizim të sistemeve lokale rurale për furnizim me ujë në pajtim me analizën e të dhënave të mbledhura mbi to

MASA 9: Rishikim i Ligjit për ujëra dhe aktet nënligjore në pjesën e dhënies të licencave/ vërtetimeve për nxjerrjen e rerës, zhavorit, dhe gurit nga brigjet dhe shtretërit e ujërave sipërfaqësore				
	numër	Angazhim në ditë*	Pagesë ditore mesatare në euro	Gjithsej mjete të duhura në euro
Ekspert vendor	1	90	120	10,800
Ekspert ndërkombëtar	1	90	350	31,500
				42,300

Shpjegim shtesë për llogaritjen:

- Eksperti lokal dhe ai ndërkombëtar do të përkrahin të punësuarit nëpër institucione, në aspekt të analizës komparative për këtë problematikë në vendet tjera dhe harmoznizim me regulloret aktuale të lidhura në RMV
- * Angazhimi kohor
- Pagat e të punësuarve për ndryshimin e regullores ligjore janë më në shpenzim të buxhetit

Bibliografia

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Sekretariati për çështje europjane(2017). Programa nacionale për miratimin e të drejtës të UE 2016-2018.
- Shkup:Qeveria e Republikës së Maqedonisë.
- Qyteti i Shkupit(2011). Plan i dytë lokal akcional ekologjik (PLAE) për qytetin e Shkup : Qytetii Shkupit
- Direktiva 2007/60/EC e Parlamentit Europjan dhe i Këshillit për vlerësim dhe menaxhim me rrezikun nga vërshimet (https://ec.europa.eu/environment/water/flood_risk/com.htm);
- Direktiva e Këshillit 2006/7/EC për kualitetin e ujit për banjo (https://ec.europa.eu/environment/water/water-bathing/index_en.html);
- Direktiva e Këshillit 98/83/EC për kualitetin e ujit për pije (https://ec.europa.eu/environment/water/water-drink/legislation_en.html);
- Direktiva 2006/11/EC e Parlamentit Europjan dhe i Këshilit për ndotje e shkaktuar nga substanca të caktuara të dëmshme të cilat lëshohen në mjedis ujor ;
- Direktiva e Këshillit 2006/118/EC e Parlamentit dhe Këshillit Europjan per mbrojtje e ujërave nëntokësore nga ndotja (https://ec.europa.eu/environment/water/water-framework/groundwater/framework.htm);
- Direktiva e Këshillit 91/271/EEC për trajtimin e ujërave të zeza urbane (https://ec.europa.eu/environment/water/water-urbanwaste/index_en.html);
- Enti shtetëror për revizion(2019). Raporti përfundimtar për revizion të kryer të suksesit "Efektivitet nga politikat,masat dhe aktivitetet gjatë dhënies të drejtës ujore". Shkup: Enti shtetëror për revizion
- Enti shtetëror për statistikë(2019). Statistika për mjedisin jetësor 2019, faqe 66. Në dispozicion në http://www.stat.gov.mk/Publikacii/ZivotnaSredina2019.pdf [30.10.2020]
- Ligji për ekonominë e ujit („Gazeta zyrtare e RM" nr.51/15, 93/15);
- Ligji për njësitë e qeverisjes lokale(„Gazeta zyrtare e RM"nr.5/02)
- Ligji për mjedisin jetësor(„Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10,124/10,51/11,123/12, 93/13,187/13 и 42/14, 44/15, 129/15, 129/15, 192/15 и 39/16);
- Ligji për mbrojtjen e blerësve(„Gazeta zyrtare e RM" nr.38/04, 77/07, 103/08, 24/11, 164/13, 97/15 и 152/15);
- Ligji për veprimtaritë komunale („Gazeta zyrtare e RM" nr.95/12, 16/13, 42/14, 44/15 и 147/15);
- Ligji për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve ujore(„Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr.7/16);
- Ligji per sigurinë e ushqimit („Gazeta zyrtare e RM" nr. 157/10, 53/11, 1/12, 164/13, 187/13, 43/14, 72/15, 84/15, 129/15, 213/15 и 39/16);
- Ligji për ujërat(„Gazeta zyrtare e RM" nr. 87/08, 6/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 23/13, 163/13, 180/14, 124/15, 146/15, 52/16);

- Ligji për furnizim me ujë të pijshëm dhe mbledhje të ujërave të zeza ("Gazeta zyrtare e RM" nr.68 / 04, 28/06, 103/08, 17/11, 54/11, 163/13, 10/15, 147 / 15, 31/16);
- Minsitria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor(2011). Strategjia nacionale e ujërave, www.moepp.gov.mk. Ka arritur në 30.10.2020 .
- Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor(2015). Strategjia për mjedis jetësor dhe ndryshime klimatike2014-2020. Shkup : Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor.
- Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor (2018). Metodologjia e përcaktimit të rrjedhjes minimale të rrjedhave sipërfaqësore dhe niveli minimal i ujërave nëntokësore. Shkup: Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor.
- Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor(2018). Plan për menaxhim dhe mbrojtje nga rreziku nga vërshimet nga derdhja e lumit Treska. Shkup:Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor.
- Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor(2018). Plan për menaxhimin dhe mbrojtjen nga vërshimet nga lumi Lepenec, Shkup : Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor.
- Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor. Dokumentacion i proektit Zhvillim i studimit nacional për ujëra. Në dispozicion në http://ws.vodamk.mk/%d0%b1%d0%b8%d0%b1%d0%bb%d0%b8%d0%be%d1%82%d0%b5%d0%ba%d0%b0/?lang=mk. [30.10.2020]
- Komuna Aerodrom(2017). Plan akcional lokal ekologjik për Kimunën Aerodrom për periudhën nga viti 2017 deri në vitin 2023 Shkup: Komuna Aerodrom
- Komuna e Manastirit (2018). Plan akcional lokal ekologjik për Komunën e Manastirit për periudhën prej vitit 2018 deri në vitin 2024. Manastir :Komuna e Manastirit.
- Komuna e Dojranit (2016). Plan akcional lokal ekologjik për komunën e Dojranit. Dojran: Komuna e Dojranit
- Komuna Kisella Vodë (2016). Plan akcional lokal ekologjik i Komunës Kisella Vodë (2016- 2021), Shkup: Komuna Kisella Vodë
- Komuna e Ohrit (2019). Plan akcional lokal ekologjik për Komunën e Ohrit (2019-2025) Ohër: Komuna e Ohrit.
- Komuna e Resnjes (2017). Plan akcional lokal ekologjik për Komunën e Resnjes (2017-2022) Resnje: Komuna e Resnjes.
- Komuna Qendër(2019). Plan akcional lokal ekologjik për Komunën e Qendrës për periudhë 2019-2025. Shkup:Komuna Qendër .
- Direktiva kornizë për ujëra 2000/60/EC (https://ec.europa.eu/environment/water/water-framework/index_en.html);
- Marrëveshja për stabilizim dhe asocim(www.sei.gov.mk);
- Rregullorja për klasifikim të ujërave sipërfaqësorë („Gazeta zyrtare e RM" nr.99/16);

Институт за
комуникациски
студии

адреса: ул. „Јуриј Гагарин“ 17-1-1, 1000 Скопје
е-маил: info@iks.edu.mk
веб: iks.edu.mk
телефон: +389 2 3090 004